

PARLAMENTI KROAT

1959

Në zbatim të nenit 88 të Kushtetutës së Republikës së Kroacisë, miratoj

VENDIMIN

PËR SHPALLJEN E LIGJIT PËR ARMËT

Me anë të këtij vendimi shpall ligjin "Për armët", të miratuar nga Parlamenti Kroat në seancën e datës 1 qershor 2007.

Kategoria: 011-01/07-01/50

Numri i regjistrimit: 71-05-03/1-07-2

Zagreb, më 6 qershor 2007

Presidenti
i Republikës së Kroacisë
Stjepan Mesić, m.p.

LIGJ PËR ARMËT

1.DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

Ky ligj rregullon blerjen, posedimin, mbajtjen, grumbullimin, prodhimin, riparimin dhe konvertimin, tregtimin, transportin e armëve, poligonet civile të qitjes, si dhe testimin dhe markimin e armëve të zjarrit. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në mënyrën e duhur për tregtinë me pakicë të armëve. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për blerjen, posedimin, mbajtjen, koleksionimin, prodhimin, riparimin dhe konvertimin, tregtinë e armëve, poligonet civile të qitjes, si dhe testimin dhe markimin e armëve të zjarrit për nevojat e Forcave të Armatosura, policisë, si dhe të organeve të tjera shtetërore e personave juridikë të Republikës së Kroacisë të përcaktuar me rregullore të veçanta.

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për armët që transportohen nëpërmjet territorit të Republikës së Kroacisë për nevojat e autoriteteve kompetente të shteteve të tjera.

Disa emra në këtë ligj janë dhënë në gjininë mashkullore, por përdoren si për gjininë mashkullore, edhe për atë femërore.

Neni 2.

Për të gjitha çështjet proceduriale që nuk rregullohen nga ky ligj zbatohen dispozitat e ligjit "Për procedurën e përgjithshme administrative".

Neni 3.

"Armë" në kuptim të këtij ligji është mjete i prodhuar ose i përshtatur për të nxjerrë plumb, saçme, qitje ose një predhë tjetër, nën presionin e ajrit, gazeve të barutit ose të gazeve të tjera apo të një lënde tjetër shtytëse, si dhe për të shpërndarë gaz ose lëng dhe mjete të tjera të projektuara për vetëmbrojtje, gjueti ose sport.

"Armë" në kuptim të këtij ligji konsiderohen edhe komponentët kryesorë të armëve.

Komponentë kryesorë të armëve janë tyta, foleja e fishekëve, kapaku i tytës, shuli, këllëfi, doreza e armës me mekanizmin e shkrepjes, si dhe cilindri te revolverët.

Neni 4

Në kuptim të këtij ligji, nuk konsiderohen armë: armët dekorative, imitimet e armëve, armët e çaktivizuara nëpërmjet veprimeve teknike të përcaktuara me rregulla të veçanta, armët e projektuara për alarm, sinjalizime, shpëtim, vrasje të kafshëve, pushkët e zhytësve dhe objekte të tjera të cilat me forcën e sustës, të llastikut të tendosur ose të gazit nën presion nxjerrin fuzhnjë ose shigjetë, që janë posaçërisht të destinuara për gjueti peshku (armë nënujore), armët që përdoren për qëllime industriale ose teknike, municionet për armët me ajër dhe armët me lak të tendosur si dhe municionet e rreme.

Neni 5.

Shprehjet e mëposhtme të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin si vijon:

- 1) *Armë automatike* është arma që mund të shkrepë disa plumba me një tërheqje të këmbëzës.
- 2) *Armë gjysmëautomatike është* arma e cila pas shkrepjes së çdo fisheku është përsëri e gatshme për të shtënë dhe nga e tyta e së cilës mund të shtihet vetëm me nga një plumb.
- 3) *Armë shpërthyes* janë të gjitha llojet e bombave, minave, granatave dhe mjeteve të tjera që përmbajnë lëndë shpërthyes ose me detonatorë të cilat, nën veprimin e duhur të brendshëm ose të jashtëm (rëndesa, goditja, lëvizja, fërkimi, reaksionet kimike, energjia elektrike etj.) çlirojnë energji dhe shpërthejnë.
- 4) *Municion* është mbushja për armët e zjarrit.
- 5) *Armë e ftohtë* janë tehet, kamat, shpatat, pinjallët, bajonetat dhe thikat me shkrepje me tehet që funksionon nën presionin e lakut të tendosur, i cili del nga doreza pas shtypjes së butonit ose të levës, dorezat ose yjet metalikë të projektuara për t'u hedhur, pavarësisht gjatësisë së tehut të tyre ose të tehut të mprehtë të fshehur, bokserët dhe armët e tjera të fshehura, me tehet të fshehur (bastunët armë, çadtrat armë etj.). Armë të ftohta konsiderohen edhe objektet e përshtatura për të shkaktuar lëndim, kur mbahen në vende publike.
- 6) *Armë zjarri* janë të gjitha llojet e mjeteve të cilat, nën presionin e gazeve të barutit, qëllojnë plumba, sfera, saçme, shigjeta ose ndonjë lloj tjetër predhe.
- 7) *Armë zjarri e shkurtër* është arma me tytë jo më e gjatë se 30 cm ose me gjatësi të përgjithshme jo më shumë se 60 cm.
- 8) *Armë zjarri e gjatë* është arma me tytë jo më të gjatë se 30 cm ose me gjatësi të përgjithshme jo më shumë se 60 cm.
- 9) *Armë zjarri me mbushje mekanike* është arma e cila pas shkrepjes së plumbit, duhet të rimbushet manualisht nga karikatorit apo cilindri.
- 10) *Armë për vetëmbrojtje* janë armët e shkurtra dhe të gjata të kalibrave të ndryshëm. Ministri kompetent për punët e brendshme përcakton llojet dhe kalibrat e lejuar.
- 11) *Armë gjahu* është arma e gjahut e kategorisë B me të cilën mund të gjuhen kafshët e egra, sipas rregullave për gjuetinë
- 12) *Armë pneumatike* janë të gjitha llojet e pushkëve, revolverëve dhe mjeteve të tjera të cilat, nën veprimin e presionit të ajrit apo të një gazi tjetër nxjerrin nga tyta plumba, sfera, saçme ose ndonjë lloj tjetër predhe.

- 13) *Armë me gaz* janë pistoletat, revolverët, pushkët dhe mjetet e tjera të cilat, nën presionin e energjisë së barutit ose të gazit të ngjeshur shpërthejnë lëndë të padëmshme irrituese për ç' aftësimin e individit, të cilat kanë një efekt afatshkurtër në shëndetin e njeriut.
- 14) *Armë për sinjalizim* janë pistoletat, revolverët, pushkët dhe mjetet e tjera të cilat, nën presionin e energjisë së mbushjes prej baruti ose të gazit të ngjeshur, shpërndajnë ose shpërthejnë mbushje të projektuar ekskluzivisht për të shkaktuar zhurmë të fortë ose për të lëshuar shenjë sinjalizuese me ndriçim.
- 15) *Substanca të lejuara të padëmshme* janë përbërjet kimike CN (klorocetofenon), CS (ortoklorbenzenmalon) dhe OC (oleoresin capsicum) në përqendrime të lejuara.
- 16) *Armë me hark ose me tojë* janë harqet dhe mekanizmat e tjerë që funksionojnë nën shtypjen e fijes së shtrënguar, të cilat gjuajnë me shigjetë apo predhë tjetër.
- 17) *Riprodhim i armëve* janë kopjet e armëve të zjarrit të gjata ose të shkurtra të cilat mbushen nga gryka e tytës me barut të zi dhe ndizen me fitil, masat ose me kapsollë.
- 18) *Paralizues elektrikë* janë mjetet dore që me ndihmën e tensionit të lartë elektrik çaftësojnë përkohësisht personin.
- 19) *Mortaja* janë mjete dore ose të fiksuara të projektuara për të shkaktuar zhurmë të fortë, të cilat janë konstruktuar në mënyrë të tillë që nuk mund të mbushen plotësisht. Ato mbushen me barut të zi, nga gryka e tytës, ndizen me strall, masat ose kapsollë dhe përmbajnë lëndë me një peshë të vogël specifike.
- 20) *Armë luftarake dhe municion* për armë të tilla janë armët dhe municioni i cili sigurohet sipas rregullave të veçanta, qarkullimi i të cilave për personat fizikë është i ndaluar ose është i kufizuar.
- 21) *Armë antike* janë armët të cilat kanë vlera historike, armët të cilat janë pjesë përbërëse e veshjeve popullore, si dhe armët ushtarake e policore të hershme dhe të papërdorshme, armët që janë pjesë përbërëse të veshjeve festive të paradave ushtarake dhe të policisë, armët e prodhuara përpara vitit 1870, si dhe armët që mbushen me barut të zi nga gryka e tytës dhe që ndizen me masat, fitil ose kapsollë.
- 22) *Armë dekorative* janë armët të cilat janë prodhuar për qëllime dekorative dhe nuk mund të përdoren ose përshtaten si armë zjarri.
- 23) *Transferim i armëve* është zhvendosja e armëve për të cilat është lëshuar leja e armës, nga njëri vend në tjetrin.
- 24) *Tregtar armësh* është personi fizik ose juridik i cili zotëron leje nga Ministria e Punëve të Brendshme për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të armëve dhe municionit, riparimit dhe konvertimit të armëve dhe të tregtimit të armëve dhe të municioneve.
- 25) *Prodhim i armëve* është prodhimi i armëve të reja të kategorisë B dhe C.
- 26) *Prodhim i municioneve* është prodhimi i municionit të ri.
- 27) *Tregtim i armëve* është blerja e armëve me qëllim shitjen, magazinimin dhe ruajtjen e tyre, si dhe shitjen me shumicë ose pakicë në Republikën e Kroacisë.
- 28) *Shitje me pakicë e municionit* është shitja e municionit, kapsollave ndezëse për municion dhe e barutit (të zi dhe me pak tym), si dhe të artikujve piroteknikë për zbatimje të kategorisë II në ambiente shitjeje për të cilat është marrë leja përkatëse, me kushtin që në këtë ambient shitjeje sasia e përgjithshme e barutit së bashku me barutin që përmbajnë municionet dhe kapsollat ose artikujt piroteknikë të mos e kalojë 20 kg neto të masës së lëndës shpërthyesë ose 60 kg neto të masës së përbërjes piroteknike në Republikën e Kroacisë.
- 29) *Riparim i armëve* është riparimi i defekteve të armëve ose ndryshimi apo montimi i pjesëve origjinale të armës.
- 30) *Konvertim i armëve* është përshtatja e armëve për një municion tjetër, ndërrimi ose vendosja e pjesëve kryesore të armës dhe konvertime të tjera në armë, të cilat ndikojnë në funksionimin e saj ose në specifikimet teknike.
- 31) *Transporti i armëve* është transporti i armëve për qëllime të tregtisë brenda kufijve shtetërorë (në vijim referuar si: transporti i brendshëm) dhe transportin e armëve të destinuara për kryerjen e aktivitetit të tregtisë përtej kufirit shtetëror (në vijim referuar si: transporti ndërkombëtar).
- 32) *Poligon civil qitjeje* është objekti i projektuar për qitje sportive rekreative, cili plotëson kushtet teknike dhe të sigurisë për përdorimin e armëve për qëllime vetëmbrojtjeje, gjuetie dhe sporti.

- 33) *Testim i armëve të zjarrit* është kontrolli për të verifikuar nëse arma dhe pjesët e saj funksionojnë siç duhet, si dhe kontrolli i qëndrueshmërisë së tytës dhe pjesëve të tjera përkatëse nën një presion të caktuar.
- 34) *Markim i armëve të zjarrit* është vendosja e markimeve të përcaktuara në pjesë të caktuara të armëve të zjarrit, të cilat janë vërtetuar se funksionojnë siç duhet gjatë testimit.
- 35) *Çaktivizim i armës së zjarrit në mënyrë të përhershme* është çaktivizimi i të gjitha pjesëve kryesore të armës, në mënyrë të tillë që nëpërmjet heqjes, ndërrimit ose konvertimit të mos mundësohet aktivizimi i saj.
- 36) *Municion manovër* është municioni pa mbushje depërtuese dhe vdekjeprurëse, i projektuar për të arritur efektin e të shtënës.
- 37) *Imitacion i armëve* janë objekte të cilat nga pamja e jashtme janë të ngjashme ose njëlloj me armën, por të cilat nuk mund të përdoren apo të konvertohen në armë zjarri.

1. Klasifikimi i armëve

Neni 6

Armë të KATEGORISË A janë:

1. predhat ushtarake me mbushje plasëse dhe mortajat,
2. armët e zjarrit automatike,
3. armët e zjarrit kamufluara në formën e një mjeti tjetër,
4. municioni me shkallë të lartë depërtuese, municioni me predha shpërthyesë, municioni me predha ndezëse, si dhe predhat për municion të tillë
5. municioni për pistoletë dhe revolver me predhë shpërndarëse dhe hapëse, si dhe predhat për municion të tillë, përveç në rastet e armëve për gjueti apo ato sportive të personave që kanë të drejtë t'i përdorin ato.
6. armët luftarake,
7. armët shpërthyesë dhe pjesët e tyre,
8. pajisjet e veçanta në përputhje me ligje të veçanta
9. armët e prodhuara ose konvertuara pa lejë për tregtim, përveç armëve të përmendura në pikën 3 të kategorisë C dhe pikën 2 të kategorisë D.
10. armët e zjarrit gjysmë automatike për përdorim civil, të cilat janë të ngjashme me armët e zjarrit automatike.

Armët e KATEGORISË B janë:

1. armë zjarri të shkurtra gjysmë automatike ose armë zjarri të shkurtra me përsëritje.
2. armë të shkurtra për një qitje, me gjilpërë goditëse në mes.
3. armë të shkurtra për një qitje me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme deri në 28 cm.
4. armë zjarri të gjata, gjysmë automatike, me krehër dhe fole fishekësh që mban më shumë se tre fishekë.
5. armë zjarri të gjata, gjysmë automatike, me krehër dhe fole fishekësh që mban më shumë se tre fishekë, me krehër që ose që nuk është e sigurt se arma është e një konstrukcioni të tillë që me vegla të zakonshme është e mundur të adaptohet në armë për më shumë se tre të shtëna me një mbushje.
6. armë zjarri të gjata gjysmë automatike me tytë të pavjaskuar, me gjatësi të përgjithshme deri në 60 cm.
7. armë zjarri të gjata me përsëritje që nuk janë përfshirë në pikën 6.
8. armë të gjata me një ose shumë të shtëna një nga një, me tytë të vjaskuar.
9. armë zjarri të gjata gjysmë automatike që nuk janë përfshirë në pikat 4 deri në 6, si dhe në pikën 10 të kategorisë A.
10. armët e zjarrit të shkurtra me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme deri në 28 cm.
11. armë të gjata për një qitje, me një ose më shumë tyta të pavjaskuara.
12. armët antike.

Armë të kategorisë C janë:

1. Armët me gaz,
2. Riprodhimet e armëve të zjarrit tek të cilat nuk përdoret mbushje unike.
3. Mortajat.

Armët e kategorisë D janë:

1. Armët me ajër,
2. Armët me hark,
3. Paralizuesit elektrikë,
4. Spërkatësit,
5. Armët e ftohta

Neni 7

Armët e përmendura në nenin 6 të këtij ligji nga këndvështrimi i të drejtave dhe detyrimeve të pronarit të armës ndahen në:

1. Armë të ndaluara – armët e kategorisë A dhe armët e të projektuara kryesisht për qëllime sulmi ose shkaktimi të plagëve, si dhe armët e ftohta kur mbahen në vende publike.
2. Armë të lejuara për të cilat kërkohet autorizim – armët e kategorisë B,
3. Armë të lejuara për të cilat kërkohet regjistrimi tek organi kompetent – armët e kategorisë C,
4. Armë të lejuara për të cilat nuk kërkohet autorizim paraprak dhe as regjistrim tek organi kompetent – armët e kategorisë D.

II. DOKUMENTET PËR ARMËT

Neni 8

Dokumentet që kërkohen për armët sipas këtij ligji janë:

1. Autorizim për blerje arme,
2. Autorizim për blerje municioni,
3. Autorizim për posedim arme ose për posedim dhe mbajtje arme,
4. Autorizim për koleksion të armëve antike,
5. Autorizim për posedim arme,
6. Autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve,
7. Dokumente të tjera lëshuar në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 9

Kërkesa për lëshimin e autorizimit për blerje arme dorëzohet në formularin e përcaktuar, pranë Drejtorisë së Policisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme në vendin e banimit, ose aty ka selinë aplikanti (në vijim: organi kompetent).

1. Lëshimi i autorizimit për blerje arme personit fizik

Neni 10.

Organi kompetent i lëshon personit fizik autorizim për blerje arme për armë të kategorisë B nëse plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta.

Kushtet e përgjithshme për lëshimin e autorizimit për blerje arme personit fizik janë:

- 1) Të ketë arsye të justifikueshme për blerjen e armëve,
- 2) Të ketë mbushur moshën 21 vjeç,
- 3) Te mos jetë dënuar me një vendim të formës së prerë për vepra penale kundër Republikës së Kroacisë, për vepra penale kundër vlerave të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare, për vepra penale

kundër jetës dhe trupit, vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, si dhe për vepra penale të cilat në vetvete përmbajnë elemente të dhunës, duke përfshirë veprat penale kundër pronës, kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, kundër lirisë së gjinisë dhe moralit, kundër martesës, familjes dhe të rinjve, kundër organeve të drejtësisë, kundër rendit publik, kundër detyrës së shërbimit, kundër Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, kundër mjedisit- tortura dhe vrasja e kafshëve- ose nëse për një veprë të tillë të dënueshme është nisur ndjekja penale.

4) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kundërvajtje apo që nuk është në proces kundërvajtjeje në fushën e rendit dhe të qetësisë publike dhe të ligjeve të tjera në të cilat janë përcaktuar kundërvajtjet që përfshijnë elemente dhune, veçanërisht për kundërvajtjet që lidhen me dhunë në familje ose nëse i është caktuar masë sigurie për shkak të dhunës në familje.

5) Të mos ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se arma mund të keqpërdoret dhe veçanërisht: përdorimi i shpeshhtë dhe tej masës i alkoolit, konsumimi i drogave narkotike ose lëndëve të tjera intoksikuese, situata të rënduara familjare, konflikte me mjedisin, sjellje agresive dhe e tepruar si dhe rëndime të tjera në sjellje, shkelje disiplinore të rregullave në gjueti ose në poligonet e qitjes etj.

6) Të ketë kushte sigurta për banimi dhe për ruajtjen e armës.

Kushte të veçanta për lëshimin e autorizimit për blerje arme personi fizik janë:

1) Të konfirmohet, përmes kontrollit mjekësor, se është i aftë nga ana shëndetësore për të mbajtur dhe poseduar armë.

2) Të zotërojë informacion teknik dhe njohuri për përdorim të rregullt të armëve dhe të njohë rregullat për posedimin dhe mbajtjen e armëve.

Duke deroguar nga neni 2 pika 2 e këtij ligji, autorizimi për blerje arme mund t'u lëshohet punonjësve të policisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, efektivëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë dhe policisë gjyqësore, pasi të kenë mbushur 18 vjeç, të cilët sipas rregullave të veçanta janë të autorizuar të posedojnë dhe të mbajnë armë, pjesëtarëve të shoqërive sportive të qitjes, të cilët marrin pjesë në mënyrë aktive në garat e qitjes dhe personave që i janë nënshtruar provimit të gjuetisë.

Neni 11.

Aplikanti vërteton se përmbush kushtet sipas nenit 10 paragrafi 3 pika 1 të këtij ligji, duke dorëzuar raportin mjekësor.

Raporti mjekësor të aftësisë për të poseduar dhe mbajtur armë lëshohet nga institucionet shëndetësore, shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime mjekësore në punë dhe specialistët privatë të ofruesve të shërbimeve të caktimit të aftësisë për punë kompetentë për kryerjen e kontrolleve shëndetësore të këtij lloji, pasi të merret paraprakisht opinioni i mjekut të zgjedhur të kujdesit shëndetësor parësor.

Personi fizik të cilit i është dhënë raporti sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të paraqitet për kontroll mjekësor çdo pesë vjet, për të konfirmuar se është i aftë për të poseduar dhe mbajtur armë.

Raporti i aftësisë për punë lëshohet me një afat vlefshmërie prej pesë vjetësh.

Personi fizik ose organi kompetent që nuk është i kënaqur me raportin e aftësisë për të poseduar dhe mbajtur armë, mund të paraqesë ankesë brenda 15 ditëve nga marrja e tij. Mjeku i zgjedhur i kujdesit shëndetësor parësor, si dhe çdo mjek tjetër që ka dijeni mbi ndryshimin e gjendjes shëndetësore ose të rrjedhës së mjekimit të zotëruesit të armës dhe që ndikon në aftësinë shëndetësore për të poseduar dhe mbajtur armë, duhet të informojë menjëherë organin për këto fakte.

Neni 12.

Aplikanti vërteton përmbushjen e kushteve sipas nenit 10 paragrafi 3 pika 2 të këtij:

1) Për armët e kategorisë B – duke dorëzuar raport të aftësisë për të poseduar, mbajtur dhe përdorur armë, të lëshuar nga organi kompetent i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2) Për armët e gjahut të kategorisë B – duke dorëzuar certifikatën e gjuetisë e cila vërteton se është dhënë provimi i gjuetisë dhe marrja me gjueti.

3) Për armët sportive –anëtarët e shoqatave sportive të qitjes të cilat garojnë në mënyrë aktive në qitje duke dorëzuar konfirmimin me shkrim të drejtuesve të shoqatës që mbajnë evidencën e pjesëtarëve të të gjitha shoqatave kroate sportive të qitjes.

Punonjësit e policisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme, anëtarët e Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë dhe të policisë gjyqësore të cilët janë të autorizuar që të posedojnë dhe mbajnë armë me rregullore të veçantë, vërtetojnë se janë përmbushur kushtet e veçanta sipas nenit 10 të këtij ligji duke dorëzuar një dokument të lëshuar nga ministria kompetente me të cilin konfirmohet se janë të aftë për të poseduar dhe mbajtur armë.

Rojet e sigurisë, të cilët janë të autorizuar që të posedojnë dhe mbajnë armë me rregullore të veçantë, vërtetojnë përmbushjen e kushteve të veçanta sipas nenit 10 të këtij ligji duke dorëzuar autorizimin për ofrim të shërbimeve private të.

Neni 13.

Personi fizik i cili ka arsye të justifikueshme për të blerë armë për vetëmbrojtje, duke provuar që siguria e tij personale është e kërcënuar ose do të mund të ishte e kërcënuar në një masë të tillë sa që i nevojitet një armë për t'u mbrojtur apo që për shkak të natyrës së punës apo rrethanave në të cilat kryen aktivitetin, duhet të blejë armë, dhe nëse nuk mund të sigurohet mbrojtje e mjaftueshme nga aktivitetet e institucioneve të sigurisë ose masa të tjera.

Personi fizik ka arsye të pranueshme për blerje të armëve të gjahut, nëse zotëron certifikatën që vërteton se i është nënshtruar provimit të gjuetisë.

Personi fizik ka arsye të pranueshme për të blerë armë sportive nëse merret në mënyrë aktive me qitje sportive.

Punonjësi i policisë është i autorizuar që të kërkojë dhe të grumbullojë të dhëna e informacione nga qytetarë për të vërtetuar përmbushjen e kushteve sipas nenit 10 paragrafi 2 pika 5 të këtij ligji. Për të dhënat dhe informacionet e grumbulluara, përpilohet raport zyrtar.

Punonjësit e policisë vërtetojnë se janë përmbushur kushtet sipas nenit 10 paragrafi 2 pika 6 të këtij ligji nëpërmjet monitorimeve të drejtpërdrejta në ambientet e banimit ose ambientet e tjera ku mbahen armët, të cilat gjenden në vendbanimin ose të selinë të pronarit ose përdoruesit të tyre dhe mbajnë një procesverbal të tyre.

Neni 14.

Organi i kërkon aplikantit që përmbush kushtet e përgjithshme sipas nenit 10 paragrafi 2 të këtij ligji që brenda 60 ditëve të paraqesë dëshmi për përmbushjen e kushteve të veçanta sipas nenit 10 paragrafi 3 pika 1 dhe 2 të këtij ligji.

Organi kompetent mund të lëshojë autorizim për blerje arme për vetëmbrojtje, për posedim ose për posedim dhe mbajtje dhe autorizim për të mbajtur armë sportive, nëse janë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 10 të këtij ligji.

Organi kompetent mund të lëshojë autorizim për blerje dhe posedim e mbajtje arme, nëse janë plotësuar kushtet sipas nenit 10 të këtij ligji.

Neni 15

Organi kompetent e refuzon kërkesën për lëshim të autorizimit për blerje arme personit fizik nëse nuk plotësohen kushtet për blerjen e armëve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Lëshimi i autorizimit për blerje arme personave juridikë

Neni 16

Organi kompetent i lëshon personit juridik autorizim për blerje arme të kategorisë B nëse plotëson kushtet si vijon:

- 1) Ka arsye të pranueshme për blerjen e armës,
- 2) Personi përgjegjës në personin juridik plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 10 të këtij ligji.
- 3) Disponon ambiente për mbajtjen dhe ruajtjen e sigurt të armëve.

Arsye të pranueshme për blerje armësh ka personi juridik i cili është regjistruar pranë organit kompetent për kryerjen e veprimtarive të gjuetisë, mbarështimit të kafshëve të egra, qitjes sportive, drejtimit të poligoneve civile, për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes fizike, aftësimin e punonjësve dhe qytetarëve për përdorim të rregullt të armëve të zjarrit, kërkimeve shkencore për të nevojiten armë, grumbullimi i të dhënave të specializuara mbi llojet e kafshëve, xhirimi i filmave dhe ekzekutimi i shfaqjeve teatrore, muzetë dhe aeroportet për të shtënë, frikësuar dhe përzënë kafshët e egra e të tjera.

Personi juridik disponon ambient të sigurt për mbajtjen dhe ruajtjen e armëve nëse plotëson kushtet e përcaktuara me rregullore të veçantë.

Neni 17

Organi kompetent e refuzon kërkesën për lëshim të autorizimit për blerje arme personave juridikë nëse nuk plotësohen kushtet për blerje arme të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 18

Personat juridikë që merren me xhirimin e filmave, ekzekutimin e shfaqjeve teatrore ose me organizimin e lojërave tradicionale të fisnikërisë dhe të shfaqjeve të tjera që përfaqësojnë trashëgiminë kulturore mund të pajisen, mbajnë dhe përdorin armë të ftohta dhe armë të kategorive A, B dhe C të cilat janë përshtatur në mënyrë të tillë që të mund të përdorin vetëm municion manovër, pa autorizim.

Neni 19

Afati i vlefshmërisë së autorizimit për blerje arme të lëshuar nga organi kompetent personave fizikë ose juridikë është gjashtë muaj pas datës së lëshimit.

Autorizimet për blerje arme dhe autorizimet për blerje municioni, të cilat nuk janë shfrytëzuar brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, personi fizik ose personi juridik ia kthen organit kompetent brenda tetë ditësh nga data e skadimit të afatit të vlefshmërisë.

3. Lejet e armëve dhe autorizimet për posedim arme

Neni 20

Për armët e blera në bazë të autorizimit për blerje arme, personi fizik ose juridik duhet të paraqesë kërkesë për regjistrim të armës pranë organit kompetent brenda tetë ditësh nga data e blerjes së tyre.

Për armët e blera në bazë të autorizimit për blerje arme, personit fizik ose juridik i lëshohet autorizim për posedim ose autorizim për posedim dhe mbajtje të armëve, ndërsa personit juridik i lëshohet autorizim për posedim të armëve.

Neni 21

Autorizimi për posedim ose autorizimi për posedim dhe mbajtje armësh lëshohet me afat vlefshmërie të njëjtë me atë të vërtetimit të aftësisë së individit për të poseduar dhe mbajtur armë.

Autorizimi për posedim arme lëshohet me një afat vlefshmërie prej dhjetë vjetësh.

Organi kompetent, me kërkesë të aplikantit, e shtyn me afatin e vlefshmërisë të autorizimit të armës sipas paragrafit 1 të këtij neni me pesë vjet, nëse vërteton se janë plotësuar kushtet sipas nenit 10 paragrafi 2 pika 1,3,4,5 dhe 6, si dhe kushtet e parashikuara në paragrafin 3 pika 1 të këtij ligji.

Organi kompetent, me kërkesë të aplikantit, e shtyn afatin e vlefshmërisë së autorizimit sipas paragrafit 2 të këtij neni me dhjetë vjet, nëse vërteton se janë plotësuar kushtet sipas nenit 16 të këtij ligji.

Neni 22

Organi kompetent e refuzon lëshimin e autorizimit të armëve për armët të cilave nuk mund t'u vërtetohet origjina, për armët të cilat nuk mbajnë markimin e testimit ose nuk janë markuar në përputhje me rregullat për testimin, markimin e testimit dhe markimin manual përpara vendosjes në treg. Gjithashtu, ai e refuzon lëshimin e autorizimit të armëve në rastin kur në procesin e regjistrimit konfirmohet ekzistenca e shkaqeve për refuzim të autorizimit për blerje arme.

Ne rastin sipas paragrafit 1 të këtij neni, armët dhe autorizimi për blerje arme konfiskohen. Armët të cilave nuk mund t'u provohet origjina dhe të cilat nuk mbajnë markimin e testimit apo nuk janë markuar në përputhje me rregullat për testimin, markimin e testimit dhe markimin manual përpara vendosjes së tyre në treg dhe të cilat janë teknikisht të parregullta, por nuk janë çaktivizuar, konfiskohen pa të drejtë kompensimi.

4. Autorizimi për blerje municioni

Neni 23

Organi kompetent mund t'u lëshojë personave fizikë ose juridikë autorizim për blerje municioni, në rast se ata kanë autorizim për posedim ose për posedim dhe mbajtje të armëve ose autorizim për blerje arme. Autorizimi sipas paragrafit 1 të këtij neni u lëshohet personave juridikë dhe fizikë që kanë leje për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të armëve, riparimit dhe konvertimit të armëve, drejtuesve të poligoneve civile të qitjes, organizatave sportive të qitjes që janë regjistruar në regjistrin e shoqatave, personave juridikë të autorizuar për zhvillimin e veprimtarive të gjuetisë, si dhe personave juridikë të autorizuar për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes së personave dhe të pasurisë.

Autorizimi për blerje municioni lëshohet nga organi kompetent, nëse aplikanti ka arsye të justifikuara për posedimin e llojit dhe të sasisë së kërkuar të municionit.

Autorizimi për blerje municioni për personat fizikë ose juridikë lëshohet nga organi kompetent, me një afat vlefshmërie prej gjashtë muajsh nga data e lëshimit.

Personi fizik ose juridik i kthen organit kompetent autorizimin për blerje municioni që nuk është shfrytëzuar brenda afatit sipas paragrafit 4 të këtij neni brenda tetë ditësh nga data e skadimit të afatit të vlefshmërisë.

5. Lëshimi i autorizimit për koleksionim të armëve antike

Neni 24

Autorizimi për koleksionim të armëve antike lëshohet me një afat vlefshmërie të pacaktuar.

Organi kompetent i lëshon autorizim për koleksionim të armëve antike personit fizik që plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përshkruara në nenin 10 të këtij ligji.

Organi kompetent i lëshon autorizim për koleksionim të armëve antike personit juridik që plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përshkruara në nenin 16 të këtij ligji.

Personi fizik dhe juridik mund të koleksionojë armë antike në rast se posedon ambientet për depozitim dhe ruajtje të sigurt të tyre.

Armët e poseduara në bazë të autorizimit për koleksionim të armëve antike nuk mund të mbahen apo përdoren dhe as nuk mund të blihet, posedohet ose të prodhohet municion për to.

Përmbushja e kushteve sipas paragrafit 2 të këtij neni vërtetohet nga Komisioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i ngritur nga Ministri i Punëve të Brendshme.

Armët e koleksionuara në bazë të autorizimit sipas paragrafit 1 të këtij neni mund t'u shiten apo dorëzohen vetëm personave të cilëve u është lëshuar autorizim për koleksionim të armëve antike.

Armët e zjarrit të cilat janë çaktivizuar, nuk mund të aktivizohen.

Bëjnë përjashtim muzetë, të cilët së bashku me armët antike, mund të koleksionojnë edhe armë të kategorisë A pikat 2,3 dhe 6 që nuk prodhohen më dhe që nuk përdoren nga forcat e armatosura ose policia.

Muzetë mund të koleksionojnë armë të kategorisë A pikat 1, 4, 5 dhe 7 dhe municione, me kushtin që të jenë çaktivizuar në mënyrë të përhershme.

Organi kompetent njofton ministrinë kompetente për kulturën lidhur me autorizimet e lëshuara për koleksionimin e armëve antike.

6. Armët objekt i regjistrimit të detyrueshëm

Neni 25

Personat fizikë mbi 18 vjeç dhe personat juridikë nuk mund të blejnë dhe të posedojnë armë të kategorisë C pa autorizim nga organi kompetent.

Personat sipas paragrafit 1 të këtij neni, të cilët blejnë armë të kategorisë C, duhet t'i regjistrojnë ato pranë organit kompetent brenda tetë ditësh pas datës së blerjes.

Për armën e regjistruar, organi kompetent lëshon një vërtetim.

Tregtari i autorizuar i armëve duhet të njoftojë organin kompetent rreth shitjes së armëve të kategorisë C brenda tetë ditësh nga data e shitjes së tyre.

7. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga dokumentet e armës

Neni 26

Arma nuk mund të mbahet pa autorizim arme.

Për transferimin e armëve për të cilat janë lëshuar dokumentet e armës, nuk është nevojitet autorizim.

Neni 27

Arma mund t'u shitet ose transferohet vetëm personave të pajisur me leje të vlefshme për blerje arme ose autorizim të vlefshëm.

Municioni mund t'u shitet ose transferohet vetëm personave që disponojnë autorizim të vlefshëm për posedim municioni. Tregtarët e armëve të cilët, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, janë të autorizuar për tregtim të armëve dhe municioneve, janë të detyruar që për shitje të armëve të cilat janë blerë në bazë të autorizimit dhe të cilat sipas këtij ligji mund të blihen në bazë të autorizimit për blerje arme, të njoftojnë organin kompetent brenda tetë ditësh nga data e shitjes.

Personat fizikë që shesin armë për të cilat është lëshuar dokumenti i armës, duhet të njoftojnë organin kompetent për shitjen e armës së blerë në bazë të autorizimit, dhe që të cilën sipas këtij ligji mund të blihet në bazë të autorizimit për blerje arme, brenda tetë ditësh nga data e shitjes.

Personat fizikë e juridikë të cilët posedojnë armë për të cilat është lëshuar dokumenti për armën janë të detyruar që, në rast shitjeje së armës, të kërkojnë çregjistrimin e saj nga organi kompetent brenda tetë ditësh nga data e shitjes. Personat fizikë të cilët posedojnë armë për të cilat është lëshuar dokumenti i armës, mund ta çaktivizojnë atë në mënyrë të përhershme te personat fizikë ose juridikë që kanë leje nga Ministria e Punëve të Brendshme për kryerjen e veprimtarisë së riparimit dhe konvertimit të armëve, për të cilën ata do lëshojnë një vërtetim.

Shpenzimet e çaktivizimit të armës mbulohen nga pronari i armës.

Pronari i armës ka detyrimin që armën e çaktivizuar në mënyrë të përhershme ta çregjistrojë pranë organit kompetent brenda tetë ditësh nga çaktivizimi i saj, duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga personi fizik ose juridik i cili disponon leje nga Ministria e Punëve të Brendshme për kryerjen e veprimtarisë së riparimit dhe konvertimit të armëve, për të cilën ata do lëshojnë një vërtetim për anulimin e dokumenteve të armës.

III. PËRDORIMI I ARMËVE DHE MUNICIONIT

Neni 28

Me armët dhe municionin duhet vepruar me kujdes të veçantë. Kujdesi i veçantë në përdorimin e armës dhe municionit tregohet me ruajtjen e tyre sipas rregullave, përdorimin e duhur dhe me mjeshtëri, mbajtjen, transferimin dhe mbajtjen në gjendje të rregullt.

Neni 29

Qytetarët duhet të respektojnë ndalimet e bëra publike për futjen e armës në ambiente ose hapësira të caktuara.

Personi fizik nuk mund të mbajë armë kur është nën ndikimin e alkoolit, drogave narkotike ose lëndëve të tjera intoksikuese; pra në një gjendje të tillë që të mos kuptojë pasojat e veprimeve të tij dhe as të kontrollojë veprimet e tij.

Rojet e sigurisë që punojnë në sektorin privat të mbrojtjes duhet ta mbajnë armën në përputhje me dispozitat e ligjit të veçantë.

1. Ruajtja e armëve dhe municionit

Neni 30

Armët dhe municioni duhet të ruhen dhe mbahen larg personave që nuk janë të autorizuar për ta poseduar, në mënyrë të veçantë larg fëmijëve; duhet të jenë të izoluar në një raft metalik veçantë, kasafortë ose një vend tjetër të ngjashëm i cili nuk mund të hapet me mjete të zakonshme.

Armët dhe municioni duhet të ruhen në ambient banimi ose në një ambient tjetër që gjendet në vendin e banimit ose në selinë e pronarit apo përdoruesit të armës dhe municionit.

Duke deroguar nga paragrafi 2 i këtij neni, personi fizik të cilit i është lëshuar autorizim për posedim arme, mund ta mbajë atë vetëm për qëllime riparimi ose konvertimi, si dhe për përdorim në poligon qitjeje, të pambushur dhe në këllëfin përkatës ose në arkëza.

Neni 31

Kur pronari i armës ose municionit lë vendbanimin e përhershëm ose të përkohshëm për më shumë se një vit, gjatë se cilës nuk e mban armën dhe municionin që posedon sipas këtij ligji në bazë të autorizimit të armës, duhet t'ia dorëzojë për ruajtje një personi që ka autorizim për posedim ose për posedim dhe mbajtje arme apo një tregtari të autorizuar për tregtinë e armëve.

Në rast se pronari i lë armët dhe municionin nën kujdesin e një personi i cili ka të drejtën e posedimit ose të drejtën e posedimit dhe mbajtjes së armëve të tilla, ai duhet të njoftojë organin kompetent brenda tetë ditësh nga dita e dorëzimit.

2. Përdorimi i armëve

Neni 32

Pronari i armës është i detyruar që armën ta mbajë në gjendje të rregullt dhe ta përdorë siç duhet dhe duke treguar kujdes maksimal. Armët nuk duhet të përdoren në vende publike apo në vende ku mund të kërcënohet siguria e qytetarëve.

Armët e gjahut nuk mund të përdoren jashtë zonës së caktuar për gjah, poligoneve civile të qitjes ose vendeve të tjera të caktuara për stërvitje në qitje.

Përfshihen nga dispozita e paragrafit 4 të këtij neni, armët pneumatike dhe harqet të cilat mund të përdoren edhe në vende të cilat për nga pozicioni ose për shkak të masave të marra të sigurisë janë të tilla që nuk kërcënojnë sigurinë e qytetarëve.

Armët pneumatike dhe harku mund të përdoret nga fëmijët në moshën mbi 11 vjeç në poligonet sportive dhe në vendet e tjera të caktuara dhe të përshtatshme për stërvitje në qitje, nën mbikëqyrjen e trajnerit i cili plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përmendura në nenin 10 të këtij ligji dhe kushtet e përcaktuara nga rregulloret për sportin.

është e ndaluar që arma t'i jepet për përdorim fëmijëve, përveçse sipas dispozitave të këtij ligji.

Armët e shkurtra dhe të gjata të gjahut dhe armët e gjata sportive, jashtë zonës së gjuetisë ose të poligonit, duhet të mbahen në këllëfë të përshtatshëm ose në arkëza dhe të pambushura, ndërsa armët e shkurtra sportive duhet të mbahen të mbyllura me çelës brenda këllëfëve apo arkëzave.

3. Dhënia për përdorim dhe huazimi i armëve

Neni 33

Personat juridikë të cilët posedojnë armë në bazë të autorizimit për mbajtje arme, mundën që për kryerjen e punëve për të cilat janë të regjistruar t'u a japin në përdorim personave të cilët përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë Ligj.

Me qëllim të kryerjes së punëve të mbrojtjes fizike, autorizimi për posedim të armëve të shkurtra të zjarrit mund t'u jepet personave juridikë, të cilët krahas kushteve të përcaktuara nga ky ligj, përmbushin edhe kushtet e përcaktuara me ligjin e veçantë.

Anëtarët e organizatave sportive të qitjes, të cilët përdorin armët e organizatës në të cilën janë anëtarësuar, për mbajtjen e këtyre armëve dhe municionit përkatës duhet të kenë vërtetim nga ajo organizatë.

Neni 34

Mund të huazohen vetëm armët e gjahut dhe armët sportive, si dhe armët antike.

Armët mund t'u jepen hua vetëm personave që kanë leje për këtë lloj arme apo autorizim për posedim të kësaj lloj arme ose autorizim për koleksionim të armëve antike.

Organizatave sportive të qitjes, të cilat ua huazojnë armët anëtarëve të tyre, janë të detyruara që për këto armë të lëshojnë një vërtetim.

Ndalohet dhënia hua e armëve pneumatike ose me hark ose tojë personave të mitur.

4. Humbja, vjedhja dhe gjetja e armëve, municioneve e dokumenteve të armëve

Neni 35

Personat fizikë dhe juridikë të cilët posedojnë armë në bazë të lejes së armës për posedim ose për posedim dhe mbajtje arme, autorizim për posedim arme ose autorizim për koleksionim të armëve antike janë të detyruar që të denoncojnë menjëherë humbjen ose vjedhjen e asaj arme apo të municionit.

Denoncimi sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet menjëherë pranë organit kompetent në vendin e ngjarjes ose të konstatimit të humbjes ose vjedhjes së armës dhe të municionit.

Personat fizikë dhe juridikë janë të detyruar që me shpenzimet e veta të njoftojnë zhdukjen e dokumenteve të armës, përveç autorizimit për posedim të armës dhe municionit, në fletoren zyrtare.

Neni 36

Kush gjen armë ose municion, apo ka informacion për armë ose municion të fshehur, duhet të njoftojë menjëherë drejtorinë më të afërt të policisë ose rajonin e policisë.

5. Ndryshimi i emrit personal, vendbanimit, emërimit apo selisë

Neni 37

Kur personat fizikë dhe juridikë që posedojnë armë në bazë të lejes së armës për posedim ose posedim dhe mbajtje arme, të cilët kanë autorizim për mbajtje arme apo koleksionim të armëve të vjetra, ndërrojnë emrin personal, vendbanimin, emërtimin ose selinë, duhet të informojnë për këtë organin kompetent brenda 15 ditësh nga data e këtij ndryshimi, për regjistrimin e të dhënave mbi armën dhe pronarin e armës në evidencat e shërbimit të organit kompetent dhe në dokumentet e armës.

IV. PROCEDURA NË RAST VDEKJEJE TË PRONARIT TË ARMËS

Neni 38

Në rast vdekjeje të pronarit të armës, një pjesëtar madhor i familjes së tij, përfaqësuesi ligjor, kujdestari, personi që ka jetuar me të në të njëjtën shtëpi ose personi tek i cili gjendej arma në momentin e vdekjes, është i detyruar që menjëherë sapo të marrë vesh për ekzistencën e armës, të njoftojë organin kompetent për dorëzimin e armës dhe municionit.

Organi kompetent për armën dhe municionin e dorëzuar sipas paragrafit 1 të këtij neni do të lëshojë një vërtetim. Trashëgimtari i armës është i detyruar që brenda 60 ditësh nga data që vendimi për trashëgiminë merr formë të prerë:

1. Ta shesë armën
2. Të paraqesë kërkesë për regjistrim të armës ose
3. Ta dorëzojë armën për ta çaktivizuar ose
4. T'ia dorëzojë armën Republikës së Kroacisë, pa asnjë kompensim.

Ben përjashtim nga neni 3 i këtij paragrafi, arma dhe municioni i trashëgimtarit minoren që do të qëndrojë në ruajtje pranë organit kompetent deri sa ai të mbushë moshën 21 vjeç.

Trashëgimtari i armës, me të mbushur moshën 21 vjeç, është i detyruar që të veprojë me armën siç përshkruhet në paragrafin 3 pika 1 – 4 e këtij ligji.

Neni 39

Trashëgimtari i armës i cili e shet atë, është i detyruar që ta çregjistrojë armën në fjalë pranë organit kompetent, brenda tetë ditësh nga data e shitjes.

Neni 40

Trashëgimtarit të armës i cili dëshiron të aplikojë për regjistrim të armës së trashëguar, organi kompetent i jep lejen e armës, nëse përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 10 të këtij ligji.

Neni 41

Nëse trashëgimtari i armës dëshiron ta mbajë atë si kujtim, duhet ta çaktivizojë armën në mënyrë të përhershme.

Çaktivizimi në mënyrë të përhershme i armës mund të kryhet nga personat fizikë dhe juridikë të autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për rregullimin e riparimin e armëve, për të cilat lëshohet një vërtetim.

Shpenzimet e çaktivizimit të armës mbulohet nga aplikanti.

Trashëgimtari i armës duhet ta çregjistrojë armën e çaktivizuar te organi kompetent, brenda tetë ditësh nga data e çaktivizimit të saj, duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga personi juridik ose fizik sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 42

Arma që trashëgimtari i dorëzon Republikës së Kroacisë kundrejt asnjë kompensimi, çregjistrohet sipas detyrës së shërbimit.

Neni 43

Nëse brenda 60 ditësh nga data që vendimi për trashëgiminë merr formë të prerë, trashëgimtari i armës nuk vepron sipas nenit 38 paragrafi 3 pika 1 – 4 e këtij ligji, organi kompetent e sekuestron armën dhe municionin e me to vepron në mënyrën e përcaktuar nga nenet 50 dhe 51 të këtij ligji.

V. SEKUESTRIMI I ARMËS, MUNICIONIT DHE DOKUMENTEVE TË ARMËS

Neni 44

Organi kompetent sekuestron armën, municionin, autorizimin për posedim të armës, lejen e armës, autorizimin për koleksionim të armëve antike të personit fizik që nuk përmbush me ndonjë nga kushtet sipas nenit 10 paragrafi 2 pikat 1, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji ose kushtin sipas nenit 10 paragrafi 3 pika 1 e këtij ligji.

Përrjashtohen nga paragrafi 1 i këtij ligji, në rast pushimi të kushtit të përgjithshëm sipas nenit 10 paragrafi 2 pika 1 e këtij ligji, personat fizikë të cilëve mund t'u merret autorizimi e armës për posedim dhe mbajtje arme dhe u lëshohet autorizim për posedim arme.

Neni 45

Organi kompetent dërgon për kontroll të jashtëzakonshëm mjekësor pronarin e armës për të cilin ka arsye të justifikuar për të dyshuar se nuk është më i aftë nga ana shëndetësore për të poseduar dhe mbajtur armë.

Pronari i armës sipas paragrafit 1 të këtij neni është i detyruar që brenda një afati prej 15 ditësh nga data e marrjes së vendimit për kontroll mjekësor të jashtëzakonshëm, t'i paraqesë organit kompetent vërtetimin e aftësisë se tij për të poseduar dhe mbajtur armë.

Shpenzimet e kontrollit mjekësor të pronarit të armës sipas paragrafit 1 të këtij neni, i cili është shpallur i aftë nga ana shëndetësore për të poseduar dhe mbajtur armë mbulohen nga organi kompetent që e ka drejtuar për kontroll mjekësor.

Pronari i armës sipas paragrafit 1 të këtij neni, për të cilin nga kontrolli i jashtëzakonshëm mjekësor vërtetohet se nuk është i aftë për të poseduar dhe mbajtur armë, i mbulon vetë shpenzimet e kontrollit të jashtëzakonshëm mjekësor.

Organi kompetent sekuestron armën, municionin, lejen e armës dhe autorizimin për koleksionim të armëve antike pronarit të armës i cili, në kontrollin e jashtëzakonshëm mjekësor, është vlerësuar i paaftë për të poseduar dhe mbajtur armë ose që nuk paraqet vërtetimin e aftësisë për posedim dhe mbajtje arme brenda afatit të përcaktuar në paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 46.

Organi kompetent sekuestron armët, municionin, autorizimin për posedimin e armës, autorizimin për koleksionimin e armëve antike dhe autorizimin për mbajtje të armës të personit juridik nëse pushon nuk ekziston më ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 16 paragrafi 1 të këtij ligji.

Neni 47

Vendimi për sekuestrimin e armëve, municioneve, autorizimi për posedim të armës, leja e armës, autorizimet për koleksionim të armëve të vjetra dhe autorizimet për mbajtje arme lëshohen nga organi kompetent.

Ankimimi kundër vendimit sipas paragrafit 1 të këtij ligji i njoftohet Komisionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për zgjidhjen e ankesave në procedimin administrativ të shkallës së dytë.

Ankimimi kundër vendimit sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk e shtyn ekzekutimin.

Neni 48

Armët, municionet, autorizimi për posedim të armës, leja e armës, autorizimet për koleksionimin e armëve antike dhe autorizimet për mbajtje armësh merren menjëherë dhe përpara përfundimit të procesit administrativ, të kundërvajtjes dhe penal, nëse bëhet fjalë për rrethana që tregojnë që arma mund të keqpërdoret dhe veçanërisht për përdorim të shpeshtë dhe tej masës të alkoolit, konsumimit të drogave narkotike ose të lëndëve të tjera intoksikuese, marrëdhëniet e renduara familjare si dhe marrja urgjente e masave për mbrojtjen nga dhuna në familje ose për mbrojtje të rendit publik, të cilat nuk mund të shtyhen, kur provat mbi të cilat duhet të bazohet vendimi janë të konfirmuara ose të paktën të jenë të besueshme.

Organi kompetent do lëshon vërtetim për armën e sekuestruar përkohësisht, municionin, autorizimin për posedim të armës, lejen e armës dhe autorizimin për koleksionim të armëve antike dhe autorizimin për posedim të armës.

Neni 49

Armët e sekuestruara dhe municionet sipas nenit 48 të këtij ligji ruhen pranë organit kompetent tek i cili vazhdon procedimi i sekuestrimit të armës.

Organi kompetent sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të ruajë armën dhe municionin e sekuestruar me kujdesin më të madh.

Neni 50

Armët dhe municionin e sekuestruar gjatë procesit administrativ, pronari mund t'i shesë ose t'ia dhurojë një personi fizik ose juridik i cili plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj brenda gjashtë muajsh nga data që vendimi për sekuestrimin e armës dhe municionit merr formë të prerë.

Nëse pronari i armës së sekuestruar nuk e shet armën dhe municionin brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, organi kompetent do ia shesë armën dhe municionin një tregtari armësh të autorizuar për shitjen e armëve. Arma dhe municioni sipas nenit 2 të këtij neni mund të nxirren në shitje maksimumi gjashtë muaj nga data e dorëzimit të tyre tregtarit të autorizuar të armëve.

Për armën dhe municionin e shitur, pronarit të armës i takon shpërblimi në shumën e dakordësuar me tregtarin e autorizuar të armëve.

Nëse tregtari i autorizuar i armëve nuk i shet armët dhe municionin sipas afateve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, ai duhet t'ia kthejë ato organit kompetent brenda tetë ditësh.

Neni 51

Armët dhe municionin e marrë me procedim administrativ dhe që nuk është shitur brenda një viti nga data që vendimi për sekuestrim ka marrë formë të prerë, pronari i armës mund t'i çaktivizojë dhe t'i mbajë si kujtim ose t'ia dorëzojë Republikës së Kroacisë.

Armët dhe municionet e sekuestruara pas përfundimit të procedimit me formë të prerë, organi kompetent ia dërgon Ministrisë së Punëve të Brendshme për disponim të mëtejshëm.

Për mënyrën e disponimit të armëve dhe municionit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij ligji vendos Komisioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili emërohet nga ministri i punëve të brendshme. Për armët dhe municionet sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, pronari nuk përfiton asnjë kompensim.

VI. DISPOZITA PËR SHTETASIT E HUAJ

Neni 52

Të drejtën për të poseduar ose për të poseduar dhe mbajtur armë sipas dispozitave të këtij ligji e kanë të drejtë vetëm të huajt të cilët në Republikën e Kroacisë banojnë në bazë të lejes së punës ose të miratimit për banim të përhershëm dhe të cilët plotësojnë kushtet sipas nenit 10 paragrafi 2 pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe të paragrafit 3 të këtij ligji, përveç kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

VII. HYRJA DHE DALJA E ARMËVE DHE MUNICIONEVE

Neni 53

Shtetasit kroatë mund të kalojnë përtej kufijve shtetërorë vetëm ato lloj armësh të cilat, sipas këtij ligji, mund të sigurohen, të posedohen dhe të mbahen.

Për qëllime gjyete dhe organizimi të garave sportive, të huajt mund të kalojnë nëpërmjet kufirit shtetëror vetëm ato lloje armësh të cilat, sipas këtij ligji, mund të sigurohen, të posedohen dhe të mbahen.

Armët dhe municioni mund të kalohen nëpërmjet kufirit shtetëror vetëm në pikat ndërkombëtare të kalimit, nëse nuk përcaktohet ndryshe nga marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 54

Shtetasit kroatë dhe të huaj janë të detyruar që kur kalojnë kufirin shtetëror, ta raportojnë armën pranë policisë kufitare. Policia kufitare sekuestron përkohësisht armën e shtetasit kroat ose të huaj i cili nuk ka raportuar armën dhe municionin dhe i ruan ato deri në përfundim të procedimit.

Neni 55

Shtetasi kroat dhe personi juridik me seli në Republikën e Kroacisë mund të fusin armë dhe municion në vend mbi bazën e autorizimit të organit kompetent.

Policia kufitare, në autorizimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, vërteton hyrjen e armëve dhe të municionit dhe informon për këtë organin kompetent.

Armët dhe municioni që sipas dispozitave të këtij ligji mund të posedohen pa autorizim, mund të futen në Republikën e Kroacisë me kusht që policia kufitare, në dokumentin përkatës mbi posedimin e armëve dhe municionit (faturë etj.), të vërtetojë hyrjen e armëve dhe të municionit dhe të informojë për këtë organin kompetent.

Pronari i armës është i detyruar që brenda një afati tetë ditor nga dita e hyrjes së armës në Republikën e Kroacisë të paraqesë kërkesë para organit kompetent për regjistrimin e armës.

Nëse për armët dhe municionin sipas paragrafit 1 të këtij neni, shtetasi kroat me banim jashtë shteti nuk ka autorizim nga organi kompetent, armët i merren këtij personi dhe me shpenzimet e tij i dërgohen organit kompetent në vendbanim, ose në vendbanimin e fundit ku ka jetuar para largimit të tij me banim të përhershëm jashtë shtetit.

Nëse shtetasi kroat me banim jashtë shtetit nuk kërkon lëshimin e dokumentit për posedim të armës dhe të municionit ose nëse organi kompetent refuzon kërkesën për posedim arme dhe municioni, do të caktohet një afat prej 30 ditësh për kthimin e armës dhe municionit jashtë shtetit.

Nëse shtetasi kroat me banim jashtë shteti nuk kthen armën dhe municionin brenda afatit të caktuar nga akti i organit kompetent sipas paragrafit 6 të këtij neni, ato i dorëzohen tregtarit të autorizuar të armëve për t'i shitur.

Armët dhe municioni mund të reklamohen për shitje të paktën gjashtë muaj nga data e dorëzimit tek tregtari i autorizuar i armëve. Shuma monetare e fituar nga shitja e armës sipas paragrafit 7 të këtij neni minus shpenzimet e shitjes i dorëzohet pronarit të armës dhe municionit.

Për armët dhe municionet të cilat mbeten të pashitura edhe pas gjashtë muajsh, veprohet në përputhje me nenin 51 paragrafi 3 dhe 4 të këtij ligji.

Neni 56

Shtetasi kroat me banim jashtë shtetit, i cili nuk ka autorizim nga organi kompetent për posedim të armëve, mund të fusë armë gjahu për qëllime gjuetie dhe municionin përkatës, nëse kjo armë dhe municion janë të regjistruara në dokumentin e udhëtimit.

Regjistrimi në dokumentin e udhëtimit i armës dhe municionit sipas paragrafit 1 të këtij neni kryhet nga misioni diplomatik ose zyra konsullore e Republikës së Kroacisë për sa kohë që shtetasi kroat posedon autorizim për mbajtjen e kësaj arme sipas rregullave të shtetit në të cilin banon.

Nëse arma dhe municioni përkatës sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk është regjistruar në dokumentin e udhëtimit, policia kufitare lëshon autorizim për lejimin e futjes së tyre, nëse shtetasi kroat posedon autorizim për mbajtjen e kësaj arme sipas rregullave të shtetit ku jeton.

Në dalje nga vendi policia kufitare ia merr autorizimin për futjen e armës sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 57

Shtetasi kroat mund të nxjerrë nga Republika e Kroacisë armët dhe municionin përkatës në bazë të lejes së armës, vërtetimit të regjistrimit të armës ose autorizimit për posedim të armës.

Neni 58

Shtetasi i huaj i cili banon në Republikën e Kroacisë në bazë të lejes së punës apo të miratimit për banim të përhershëm mund të fusë dhe të nxjerrë armë dhe municionin përkatës me të njëjtat kushte si dhe shtetasi kroat me banim në Republikën e Kroacisë.

Neni 59

Shtetasi i huaj i cili është në transit ose vjen në Republikën e Kroacisë për qëllime gjueti mund të kalojë nëpërmjet kufirit shtetëror armë dhe municionin përkatës nëse e ka të regjistruar atë në dokumentin e udhëtimit.

Regjistrimi i armës dhe municionit në dokumentin e udhëtimit sipas paragrafit 1 të këtij neni kryhet nga misioni diplomatik ose zyra konsullore e Republikës së Kroacisë, nëse shtetasi i huaj posedon autorizim për mbajtjen e kësaj arme sipas rregullave të shtetit në të cilin jeton.

Neni 60

Shtetasi i huaj mund të posedojë armë dhe municion të cilat do i nxjerrë nga Republika e Kroacisë nëse ka autorizim nga organi kompetent të lëshuar në Republikën e Kroacisë ose jashtë shteti.

Tregtari i armëve i autorizuar ose qytetari që i shet armën një shtetasi të huaj duhet ta dërgojë armën ose municionin deri në kufirin shtetëror dhe t'ia dorëzojë atë shtetasit të huaj në prani të punonjësit të policisë kufitare.

Neni 61

Anëtarët e organizatave të huaja të qitjes mund të kalojnë përmes kufirit shtetëror armët sportive dhe municionin për të marrë pjesë në garat sportive në Republikën e Kroacisë, sipas dispozitave të nenit 59 të këtij ligji.

VIII. ZBATIMI RRJEDHIMOR I RREGULLAVE TË TJERA

1. Futja e armëve

Neni 62

Shtetasit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian mund të futin në Republikën e Kroacisë armë të cilat janë regjistruar në lejen evropiane, duke marrë autorizim paraprak nga organi kompetent.

Kërkesa për lëshim të autorizimit për futjen e armëve në Republikën e Kroacisë sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të paraqitet edhe në misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Republikës së Kroacisë në vendbanimin e shtetasit të Bashkimit Evropian sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Autorizimi për futjen e armëve në Republikën e Kroacisë lëshohet me afat vlefshmërie për një vit.

Autorizimi për futjen e armëve në Republikën e Kroacisë mund të zgjatet me një vit.

Autorizimi për futjen e armëve në Republikën e Kroacisë nuk lëshohet nëse ekzistojnë shkaqe që lidhen me rendin publik, sigurinë e njerëzve dhe pasurisë apo të sigurisë së shtetit.

Autorizimi për futjen e armëve në Republikën e Kroacisë nuk lëshohet nëse armët janë të regjistruara në lejen evropiane të armëve, për:

- gjahtarët që posedojnë deri në tre copë armë dhe 500 copë municione për çdo armë
- qitësit sportive që posedojnë deri në tre copë armë sportive dhe 500 copë municione për çdo armë.

2. Mbajtja dhe transporti i armëve

Neni 63

Shtetasit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian mund t'i mbajnë dhe kalojnë armët e regjistruara në lejen evropiane të armëve nëpër territorin e Republikës së Kroacisë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të këtij ligji.

Me kërkesë të shtetasve të huaj, për shtetasit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që disponojnë autorizim ose lejeqëndrimi të përhershme në territorin e Republikës së Kroacisë organi kompetent lëshon leje evropiane të armës me kusht që arma për të cilën kërkohet leja të jetë e pajisur me leje arme të lëshuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Ne sekuestrimin apo marrjen e armëve, dokumenteve për armën dhe lejeve evropiane të armëve, zbatohen dispozitat e këtij ligji.

3. Nxjerrja e armëve jashtë territorit të shtetit

Neni 64

Organi kompetent i lëshon autorizim për nxjerrjen e armëve nga Republika e Kroacisë drejt një shteti anëtar të Bashkimit Evropian personit fizik që disponon dokumentin përkatës sipas këtij ligji dhe ka marrë miratim paraprak nga shteti anëtar i Bashkimit Evropian, nëse kërkohet.

Autorizimi për transport të armëve për tregtarët e huaj të armëve lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Autorizimi për transport të armëve sipas paragrafit 2 të këtij neni lëshohet nëse tregtari i armëve me origjinë nga një shtet tjetër posedon autorizim për nxjerrje të armëve jashtë vendit.

Autorizimin për nxjerrjen e armëve jashtë shtetit, tregtarit të huaj ia lëshon Ministria kompetente për tregtinë.

Autorizimi sipas nenit 1 dhe 2 të këtij neni nuk lëshohet nëse personi fizik nuk plotëson kushtet sipas nenit 10 të këtij ligji.

Autorizimi sipas nenit 1 dhe 2 të këtij neni nuk lëshohet nëse tregtari i huaj i armëve nuk përmbush kushtet sipas nenit 10 paragrafi 2 pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji.

Neni 65

Një shtetas i huaj dhe personi përgjegjës i personit juridik me seli në një shtet tjetër të Bashkimit Evropian ka detyrimin që me kërkesë të organit kompetent dhe organeve doganore të paraqesë dokumentet me të cilat të provojë të drejtën e tij për të futur dhe nxjerrë armë në territor.

IX PRODHIMI I ARMËVE DHE MUNICIONEVE

Neni 66

Me prodhim armësh mund të merren shoqëritë tregtare të cilat, përpara regjistrimit në regjistrin gjyqësor të gjykatës tregtare, marrin leje nga Ministria e Punëve të Brendshme për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të armëve.

Shoqëritë dhe tregtarët lejohen që të prodhojnë municione sipas kushteve të përcaktuara nga rregullat për prodhimin e lëndëve shpërthyesë.

Prodhim municionesh nuk do të konsiderohet mbushja e fishekëve për nevoja personale që lidhen me gjuetinë dhe qitjen sportive.

Neni 67

Leja për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të armëve lëshohet nëse personi i ngarkuar për drejtimin e shoqërisë tregtare përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 10 të këtij ligji.

Kërkesa për lëshimin e lejes për prodhim armësh refuzohet nëse personi i ngarkuar me drejtimin e shoqërisë tregtare nuk është shtetas kroat ose nuk e ka vendbanimin në territorin e Republikës së Kroacisë ose është një shtetas huaj i cili nuk qëndron në Kroaci mbi bazën e lejes së punës ose të lejes së qëndrimit të përhershëm.

Neni 68

Shoqëritë tregtare sipas nenit 66 paragrafi 1 të këtij ligji duhet të informojnë organin kompetent për regjistrimin e veprimtarisë së përmendur në regjistrin gjyqësor të gjykatës tregtare brenda tetë ditëve.

Neni 69

Shoqëria tregtare sipas nenit 66 paragrafi 1 të këtij ligji nuk mund ta fillojë punën derisa Komisioni i drejtorisë kompetente të policisë të ketë vërtetuar se:

1) shoqëria tregtare ka të drejtën e pronësisë ose të drejtën e përdorimit të ambienteve të punës në të cilat do kryhet prodhimi i armëve.

2) ambienti i punës në të cilin do të kryhet prodhimi i armëve është në përputhje me rregulloret për kushtet e veçanta hapësinore dhe teknike për prodhim të sigurt dhe vendosje të sigurt të armëve, si dhe për mbrojtjen nga zjarri, vjedhjet dhe aksidente të tjera ose keqpërdorimi.

Shoqëria tregtare sipas nenit 66 paragrafi 1 të këtij ligji, brenda një viti nga data e lëshimit të lejes për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të armëve, i kërkon komisionit sipas paragrafit 1 të këtij neni që të konfirmojë përmbushjen e kushteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Leja për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të armëve skadon nëse prodhimi i armëve nuk fillon brenda një afati njëvjeçar nga data e lëshimit të lejes ose nëse kjo veprimtari nuk është zhvilluar për të paktën një vit pas përmbushjes së kushteve për fillimin e kryerjes së veprimtarisë.

Neni 70

Gjatë procesit të prodhimit, armët nuk duhet të përdoren drejtpërdrejt nga persona të cilët nuk plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të nenit 10 të këtij ligji.

Organi kompetent i lëshon personit sipas paragrafit 1 të këtij neni leje për përdorim të drejtpërdrejtë të armës.

Ambientet në të cilat vendosen armët e prodhuara duhet të kenë siguri fiziko-teknike që parandalon hyrjen e personave të paautorizuar.

Neni 71

Përpara se të vendosen në treg, armët duhet të jenë të markuara me vulë ose me një markim tjetër në përputhje me rregullat e testimit dhe markimit me vulë të armëve të zjarrit.

Prodhuesi i armëve i dorëzon Ministrisë së Punëve të Brendshme markimin e stampuar (markimin mekanik) për çdo armë të prodhuar, brenda 15 ditëve nga data e prodhimit, me qëllim regjistrimin e tij në regjistër.

Për të testuar performancën e armës së prodhuar, shoqëritë tregtare të regjistruara për ushtrimin këtij aktiviteti mund të posedojnë dhe të mbajnë llojet dhe sasi të nevojshme të municioneve.

X. TREGTIA E ARMËVE DHE MUNICIONEVE

Neni 72

Me tregtim me pakicë të armëve mund të merren shoqëritë tregtare dhe tregtarët të cilët, përpara regjistrimit në regjistrin gjyqësor ose tregtar, kanë marrë leje nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Dispozitat e neneve 66, 67, 68, 69, 70 paragrafi 1 dhe 2 dhe të nenit 71 të këtij ligji zbatohen në mënyrën e përcaktuar për tregtinë e armëve dhe të municioneve

Magazinat në të cilat vendosen dhe ruhen armët e municionet e përcaktuara për tregti me shumicë duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ligji ose rregulloret e miratuara mbi bazën e ligjit dhe në lidhje me vendosjen ose ruajtjen e lëndëve shpërthyes.

XI. RIPARIMI DHE KONVERTIMI I ARMËVE

Neni 73

Me riparimin dhe ribërjen e armëve mund të merren shoqëritë tregtare dhe tregtarët të cilët, përpara regjistrimit në regjistrin gjyqësor ose në regjistrin tregtar, kanë marrë leje nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Dispozitat e neneve 66, 67, 68, 69, nenit 70 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 71 të këtij ligji zbatohen përkatësisht edhe për riparimin dhe konvertimin e armëve.

Neni 74

Armët e konvertuara duhet t'i nënshtrohen testimit.

Shoqëritë tregtare dhe tregtarët, të cilët janë regjistruar për riparimin dhe konvertimin e armëve, mund të pranojnë për riparim ose konvertim vetëm armë të regjistruara.

Shoqëria tregtare ose tregtari i regjistruar për kryerjen e një aktiviteti të konvertimit të armëve, duhet të njoftojë organin kompetent brenda tetë ditësh nga data e konvertimit.

Neni 75

Arma e marrë për riparim ose konvertim nuk mund të nxirret nga ambientet e përcaktuara të punës derisa t'i dorëzohet pronarit.

Përbashkohet rasti kur arma e cila është marrë për riparim ose ribërje nxirret nga ambientet e përcaktuara për punë deri në dorëzimin e saj pronarit nëse kjo është e nevojshme për arsye riparimi, ribërje ose testimi të armës.

Me qëllim të performancës së armës së ribërë shoqëria tregtare dhe e qarkullimit të cilat janë të regjistruara për ushtrimin këtij aktiviteti mund të posedojnë dhe të mbajnë llojet dhe sasi të nevojshme të municioneve.

XII. TRANSPORTI I ARMËVE DHE MUNICIONEVE

Neni 76

Transporti i armëve kryhet në bazë të autorizimit.

Autorizimi për transport të armëve të destinuara për tregtim në tregun e brendshëm lëshohet nga Drejtoria e Policisë e vendit nga fillon transporti, ndërsa autorizimi për transport ndërkombëtar lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Për armët e kategorisë D nuk nevojitet autorizim për transport të armëve.

Armët dhe municioni mund të transportohet përtej kufirit shtetëror vetëm nëpërmjet pikave të kalimit kufitar, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 77

Së bashku me kërkesën për lëshimin e autorizimit për transport të armëve sipas nenit 76 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, jepen edhe të dhënat e mëposhtme:

- 1) emri dhe adresa e dërguesit
- 2) emri dhe adresa e marrësit
- 3) emri dhe adresa e prodhuesit të armëve
- 4) lloji, marka, modeli, numri i serisë, kalibri, sasia dhe mënyra e paketimit të armës,
- 5) etiketa e llojit, targa e mjetit të transportit, emri dhe mbiemri i drejtuesit të mjetit dhe shoqëruesit, si dhe numri i pasaportës,
- 6) data dhe ora e përfaqësimit të fillimit të transportit, drejtimi dhe destinacioni.
- 7) emri i pikës së kalimit kufitar për hyrje dalje, si dhe e kalimit të armëve nëpërmjet pikës së kalimit kufitar.
- 8) masat e sigurisë gjatë transportit të armëve,
- 9) autorizimi për import ose eksport të lëshuar nga ministria përgjegjëse për tregtinë, kur kemi të bëjmë me import ose eksport armësh.

Organi kompetent për lëshimin e autorizimit për transport të armëve mund të urdhërojë, sipas nevojës, marrjen e masave të tjera të sigurisë në rastin e transportit të armëve (drejtimi, shoqërimi i dërguesit ose transportuesit, shoqërim me polici etj.)

Neni 78

Për transportin e municioneve zbatohen rregulloret për transportin e lëndëve shpërthyes.

XIII. POLIGONET CIVILE TË QITJES

Neni 79

Poligonet civile për zhvillimin e aktiviteteve sportive (në vijim referuar si: poligonet civile) mund të ngrihen nga persona fizikë dhe juridikë, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, pas marrjes së autorizimit për kryerjen e aktiviteteve të tilla nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Dispozitat e neneve 66, 67, 68, 69, 70 paragrafi 1 dhe 2 dhe të neni 71 të këtij ligji zbatohen në mënyrën e përcaktuar edhe për poligonet civile të qitjes.

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për poligonet e gjuetisë, të cilat personat juridikë të regjistruar për kryerjen e aktiviteteve të gjuetisë në kuadrin e terreneve të gjahut, i përdorin për qitje dhe për të testuar armët e gjahut të anëtarëve të tyre sipas rregullave të gjuetisë.

Neni 80

Në poligonet civile mund të qëllonjë me armë zjarri vetëm personat fizikë të cilët janë të autorizuar me ligj për të poseduar armë të tilla.

Në raste të veçanta,

Municipioni për të cilin personat fizikë dhe juridikë sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk posedojnë armë dhe autorizim për mbajtje të armës, mund të posedohet në bazë të miratimit të organit kompetent.

XIV. PROVA DHE SHËNJIMI ME STAMPË I ARMËVE TË ZJARRIT

Neni 82

Provën dhe shënjimin me stampë të armëve të zjarrit e kryen prodhuesi i armëve, ndërsa mbikëqyrjen e këtyre veprimeve e kryen Ministria e punëve të brendshme.

Neni 83

Armët e zjarrit të prodhuara në Republikën e Kroacisë para vënies në qarkullim i nënshtrohen provës dhe shënjimit me një stampë shtetërore të përcaktuar veçanërisht sipas dispozitave të këtij Ligji. Provës dhe shënjimit para vënies në qarkullim i nënshtrohen dhe armët e zjarrit të ribëra të cilave me ribërje u është ndërruar pjesa e qenësishme.

Armët e prodhuara duhet të provohen dhe të shënjohen me shenjë unike e cila përmban emrin e prodhuesit, emrin e vendit ku janë prodhuar dhe numrin e serisë.

Dispozitat e këtij Ligji që kanë të bëjnë me provat dhe shënjimin me stampë shtetërore të përcaktuar veçanërisht të armëve të zjarrit, nuk aplikohen tek armët e zjarrit:

1. Të cilat janë importuar ose importohen ose që futen nga jashtë shteti në se jashtë shteti janë provuar dhe shënjuar me stampë.
2. Të cilat importohen nga jashtë shteti ekskluzivisht për qëllime kërkimore,
3. Te cilat lëvizin nëpërmjet territorit të Republikën së Kroacisë,
4. Armët e vjetra.

Neni 84

Për çdo armë e cila është importuar në Republikën e Kroacisë për t'u shitur, importuesi është i detyruar që Brenda një afati 15 ditor nga dita e importimit, të dërgojë shenjën e armës (gjurmën mekanike) në Ministrinë e punëve të brendshme për futjen e shenjës në evidencën e përcaktuar.

Neni 85

Armët e zjarrit të cilat nuk janë të provuara dhe të shënuara nuk mund të vihen në qarkullim.

Personat fizikë dhe juridikë të cilët kanë të regjistruar armë në territorin e Republikën së Kroacisë, janë të detyruara që t'i mundësojnë Ministrisë së punëve të brendshme shenjën e armës (gjurmën mekanike) për futjen e shenjës në evidencën e përcaktuar.

Për marrjen e shenjës së armës nga personat fizikë e juridikë nuk merret pagesë.

Armët e personave fizikë e juridikë, të cilave për shkak të defekteve teknike, nuk ka qenë e mundur t'u merret shenjë (gjurmë mekanike), pronari mundet që me shpenzimet e veta t'i bëjë të përdorshme përgjithnjë.

Me armët të cilat pronari sipas paragrafit 3.te këtij neni nuk i bën të përdorshme përgjithnjë, veprohet në të njëjtën mënyrë si është përkrahur në nenin 22 të këtij ligji.

Neni 86

Shpenzimet e provës dhe shënjimit të armëve të zjarrit i mbulon prodhuesi ose importuesi i armëve.

Marrja e shenjave të armëve të personave fizikë dhe juridikë sipas nenit 84.kryhet nga Ministria e punëve të brendshme pa shpërblim.

XV. MBIKËQYRJA

Neni 87

Inspektorët e punëve të brendshme kryejnë mbikëqyrjen direkte mbi punën e personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është dhënë leje për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, qarkullimit, të riparimit dhe të ribërjes së armëve, magazinimin, mbajtjen dhe ruajtjen e armëve e municioneve, funksionimit të poligoneve civile si dhe të mbajtjes së evidencave të përcaktuara.

Neni 88

Në kryerjen e mbikëqyrjes mbi punën e personave fizikë e juridikë të cilëve u është dhënë leje për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, qarkullimit, të riparimit dhe të ribërjes së armëve, magazinimin, mbajtjen dhe ruajtjen e armëve e municioneve, funksionimit të poligoneve civile, inspektorët sipas nenit 87.të këtij Ligji janë të autorizuar që:

1) Të kontrollojnë magazinat e armëve dhe municioneve, poligonet civile dhe ambientet e tjera ku prodhohen, riparohen ose ribëhen armët, kryhet qarkullimi dhe ruhen armët e municioni, të kryejnë kontrollin e evidencave të përcaktuara dhe dokumentacionit tjetër lidhur me prodhimin, qarkullimin, riparimin dhe ribërjen e armëve, magazinimin, qarkullimin, ruajtjen e armëve e municioneve dhe funksionimin e poligoneve civile.

2) Përkohësisht të ndalojë kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, qarkullimit, të riparimit dhe të ribërjes së armëve, funksionimit të poligoneve civile dhe të urdhërojë që parregullshmëritë e konstatuara të eliminohen brenda një afati të përcaktuar prej tij.

3) Të ndalojë aktivitetin e mëtejshëm të prodhimit, qarkullimit, të riparimit dhe të ribërjes së armëve, funksionimit të poligoneve civile në se konstaton që gjatë kryerjes së këtyre veprimtarive janë bërë anashkalime të rënda në marrjen e masave mbrojtëse dhe të sigurisë ose veprime të tjera që dënohen rëndë, nëse ka pushuar së ekzistuari ndonjëri nga kushtet me të cilët është dhënë autorizimi ose në se nuk veprohet sipas autorizimit të organit kompetent.

- 4) T'i marrë lejen për përdorim direkt të armëve të zjarrit personit i cili nuk plotëson më kushtet sipas nenit 10 paragrafi 2 pikat 1, 3, 4 dhe 5 dhe nenit 10 paragrafi 3 pika 1 të këtij ligji
- 5) Të urdhërojë marrjen e masave të tjera të përcaktuara.

XVI. REGJISTRAT

Neni 89

Organi kompetent me qëllim kontrollin e posedimit, regjistrimit dhe lëvizjes së armëve mban evidence mbi lëshimin e autorizimeve për posedim të armëve, mbi lëshimin e autorizimeve për posedim të municioneve, lejeve të lëshuara të armëve, autorizimeve të lëshuara për koleksionimin e armëve antike, autorizimeve të lëshuara për mbajtje të armës, lejeve të lëshuara për përdorim direkt të armëve të zjarrit, mbi armët dhe municionet e marra, të gjetura dhe të dorëzuara, autorizimeve të lëshuara për transportimin e armëve, mbi autorizimet e lëshuara për posedim dhe mbajtje të armëve të gjuetisë dhe atyre sportive gjatë kohës së qëndrimit në Republikën e Kroacisë, mbi autorizimet e lëshuara për lëvizjen e armëve dhe municioneve nëpërmjet territorit të Republikës së Kroacisë, mbi armët e municionit e sekuestruara përkohësisht në kalimet kufitare dhe dokumentet mbi armët e municionet të lëshuara në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Brendshme mban evidence mbi lejet e lëshuara për prodhim të armëve, qarkullimin e armeve dhe municioneve, riparimin dhe ribërjen e armëve, transportin e armëve dhe municioneve si dhe krijimin e drejtimin e poligoneve civile.

Të dhënat personale që përmbajnë evidencat sipas këtij neni, grumbullohen, ruhen dhe përpunohen në përputhje me dispozitat e rregullave me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.

Neni 90

Organizatrat sportive të qitjes dhe personat juridikë të regjistruar për kryerjen e aktiviteteve të gjuetisë si dhe personat e tjerë juridikë të cilët armët e municionet i kane poseduar dhe regjistruar për shkak të kryerjes së veprimtarisë së tyre, janë të detyruar që për këto armë e municione si dhe për armët e municionet që japin për përdorim të mbajnë evidencë.

Evidencë duhet që të mbajnë shoqëritë tregtare për:

– prodhim të armëve, mbi armët e prodhuara dhe të dërguara si dhe mbi provat e shënjimim me stampë të armëve të zjarrit.

Evidencë duhet që të mbajnë shoqëritë tregtare dhe të qarkullimit për:

– qarkullimin e armëve dhe të municioneve mbi furnizimin dhe shitjen e armëve dhe të municioneve,

– riparimin dhe ribërjen e armëve për armët e riparuar dhe të ribëra,

– drejtimin e poligoneve civile për armët ne posedim dhe për armët qe jepen në përdorim si dhe për municionin e furnizuar dhe të shpenzuar.

Personat fizikë dhe juridikë të cilëve u është lëshuar autorizimi për koleksionimin e armëve antike janë të detyruar të mbajnë regjistra për armët e grumbulluara.

Evidencat sipas paragrafit 2,3 dhe 4 të këtij neni ruhen përgjithmonë dhe në rast vdekjeje të personit fizik ose të pushimit të ekzistencës së shoqërisë tregtare apo qarkulluese, regjistrat i dorëzohen organit kompetent.

XVII. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 91

Me gjobë në të holla deri në 10 000,00 kuna ose me dënim me burg deri 60 ditë dënohet personi fizik i cili në mënyrë të paautorizuar siguron, posedon, mban, prodhon, shet, shkëmben ose i jep tjetrit armë të cilat me këtë Ligj janë të ndaluara.

Me gjobë në të holla nga 5000,00 deri në 50 000,00 kuna ose me dënim me burg deri 45 ditë dënohet për kundërvajtje personi fizik që:

1. Pa autorizim blen, posedon, mban armë për posedimin e të cilave kërkohet autorizim (neni 10.)
2. Që i jep në përdorim armë fëmijëve (neni 32 paragrafi 7)

Me gjobë në të holla nga 50 000,00 deri në 500 000,00 kuna dënohet personi juridik i cili në mënyrë të paautorizuar siguron, posedon, mban, prodhon, shet, shkëmben ose i jep tjetrit armë ose municion të cilat me këtë Ligj janë të ndaluara.

Për kundërvajtjet sipas paragrafit 3 të këtij neni do të dënohet me dënim me të holla dhe personi përgjegjës në personin juridik.

Për kundërvajtjet sipas paragrafit 3 të këtij neni jepet dhe masa mbrojtëse e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit, qarkullimit, riparimit dhe ribërjes të armëve ose drejtimi I poligonit civil në se kryerja e kësaj veprimtarie është miratuar me këtë Ligj.

Për kundërvajtjet sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni përveç dënimit të parashikuar jepet dhe masa mbrojtëse e sekuestrimit të armëve dhe municionit.

Neni 92

Me gjobë në të holla nga 3000,00 deri në 15 000,00 kuna ose me dënim me burg deri në 30 ditë dënohet për kundërvajtje personat fizikë në vijim:

- 1) Mjeku i zgjedhur i shërbimit mjekësor parësor dhe çdo mjek tjetër që nuk informon menjëherë organin kompetent për ndryshimin e gjendjes shëndetësore ose rrjedhën e mjekimit të pronarit të armës, e cila ndikon në aftësinë e tij për të poseduar dhe mbajtur armë (neni 11 paragrafi 6)
- 2) Nëse në mënyrë të paautorizuar siguron, posedon, mban, prodhon, shet, shkëmben ose i transferon personave të tjerë municione të ndaluara sipas me këtij ligji.
- 3) Nëse nuk shkon për kontroll mjekësor çdo pesë vjet (neni 11 paragrafi 3).
- 4) Nëse nuk i lejon punonjësit e policisë që të konfirmojnë kushtet për mbajtje dhe ruajtje të sigurt të armëve (neni 13 paragrafi 4)
- 5) Nëse nuk paraqet kërkesë për regjistrimin e armës në afatin e caktuar (neni 20 paragrafi 1)
- 6) Nëse posedon municion pa autorizim nga organi kompetent (neni 23 paragrafi 1)
- 7) Nëse koleksionon dhe mban armë antike pa autorizim (neni 24 paragrafi 2)
- 8) Nëse armët antike dhe armët që mban mbi bazën e autorizimit për koleksionim të armëve antike, i mban ose i përdor si armë ose për to posedon, mban ose prodhon municion (neni 24 paragrafi 5)
- 9) Nëse armët sipas nenit 24 paragrafi 1 të këtij ligji i shet ose ia dorëzon një personi i cili nuk ka autorizim për koleksionim të armëve antike (neni 24 paragrafi 7)
- 10) Nëse armën e çaktivizuar e aktivizon për përdorim (neni 24 paragrafi 8)
- 11) Nëse shet ose ia dorëzon armën një personi që nuk ka autorizim të vlefshëm për posedim të armëve ose leje arme të vlefshme (neni 27 paragrafi 1)
- 12) Nëse nuk njofton organin kompetent në afatin e caktuar për çaktivizimin e përhershëm të armëve me qëllim asgjësimit të dokumenteve të tyre (neni 27 paragrafi 8)
- 13) Nëse vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 28 paragrafi 2 të këtij ligji.
- 14) Nëse nuk respekton rregulloret e publikuara në lidhje me ndalimin e mbajtjes së armëve në ambiente ose hapësira të caktuara (neni 29 paragrafi 1)
- 15) Personi që mban armë nën ndikimin e alkoolit, drogave narkotike ose lëndëve të tjera intoksikuese, në një gjendje të tillë që nuk mund të kuptojë pasojat e veprimeve të tij; pra që nuk është në gjendje të kontrollojë vetveten.
- 16) Truprojat e sigurisë të cilët mbajnë, jashtë orarit të punës, armën e zjarrit që përdorin gjatë kryerjes së detyrës.
- 17) Nëse armën dhe municionin nuk e ruan në përputhje me dispozitën e nenit 30 të këtij ligji.
- 18) Nëse armën që posedon në bazë të autorizimit për posedim arme e mban në kundërshtim me dispozitën e nenit 30 paragrafi 3 të këtij ligji.

- 19) Nëse nuk e dorëzon armën dhe municionin kur largohet nga vendbanimit i përkohshëm ose i përhershëm. (neni 31 paragrafi 1)
 - 20) Nëse e përdor armën në kundërshtim me dispozitat e nenit 32 paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji.
 - 21) Nëse armët pneumatike ose harkun dhe shigjetën ia jep në përdorim fëmijëve nën moshën 11 vjeç dhe jashtë poligoneve sportive ose vendeve të përcaktuara dhe të pajisura për ushtrimin e qitjes dhe pa mbikëqyrje të specialistit (neni 32 paragrafi 6)
 - 22) Nëse armët e gjata të gjahut dhe armët e tjera sportive jashtë terreneve të gjuetisë ose poligonit të qitjes nuk i transporton në këllëfët përkatës ose në arkëza, të pambushura, dhe armët e shkurtra të gjahut dhe armët e shkurtra sportive të mbyllura në këllëfë ose arkëza ose nëse transportohen të mbushura me municion (neni 32 paragrafi 8)
 - 23) Nëse e huazon armën në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 të këtij ligji.
 - 24) Nëse ia huazon armën një personi që nuk ka leje arme, autorizim për posedim arme ose autorizim për koleksionim të armëve antike (neni 34 paragrafi 2)
 - 25) Nëse ia huazon armën pneumatike ose me hark personave të mitur (neni 34 paragrafi 4)
 - 26) Nëse nuk raporton menjëherë humbjen ose vjedhjen e armës (neni 35 paragrafi 1)
 - 27) Nëse gjatë kalimit të kufirit shtetëror nuk ia raporton armën policisë kufitare (neni 54 paragrafi 1)
 - 28) Nëse prodhon municion në kundërshtim me dispozitën e nenit 66 paragrafi 3 të këtij ligji.
- Për kundërvajtjet sipas paragrafit 1, përveç atyre të parashikuar anë pikën 1, 9 dhe 10 të këtij ligji jepet dhe masa mbrojtëse e sekuestrimit të armës dhe municionit.

Neni 93

Personat fizikë dënohen me gjobë në të holla nga 1000,00 deri në 10 000,00 kuna nëse:

- 1) nuk raporton armët e kategorisë C në afatin e caktuar (neni 25 paragrafi 2),
- 2) mban armë pa leje arme (neni 34),
- 3) nuk e çregjistron armën në afatin e caktuar (neni 27 paragrafi 4),
- 4) nuk njofton në afatin e caktuar për dorëzimin e armës dhe të municionit në ruajtje (neni 31 paragrafi 2),
- 5) nuk e mirëmban armën ose e përdor atë në kundërshtim me rregullat apo në mënyrë të pakujdesshme (neni 32 paragrafi 1),
- 6) armën dhe municionin e organizatës sportive të qitjes i mban pa vërtetim nga organizata në fjalë (neni 33 paragrafi 3),
- 7) nuk njofton për ndryshimin e emrit personal ose të adresës së banimit brenda afatit të caktuar (neni 37),
- 8) nuk njofton organin kompetent për vdekjen e pronarit të armës, me qëllim dorëzimin e saj (neni 38 paragrafi 1),
- 9) nuk mban të dhënat sipas nenit 90 paragrafi 4 të këtij ligji

Për kundërvajtjet sipas paragrafit 1 pikat 1 dhe 5 të këtij neni jepet dhe masa mbrojtëse e sekuestrimit të armës.

Neni 94

Tregtari dënohet me gjobë në të holla nga 5000,00 deri në 15 000,00 kuna dënohet nëse:

- 1) blen ose posedon armë apo municione të ndaluara sipas këtij ligj,
- 2) blen dhe posedon armë të cilat mund të blihen vetëm me autorizim (neni 10),
- 3) i shet municion personit juridik që nuk disponon autorizim për blerje municioni (neni 23 paragrafi 1),
- 4) tregtari i autorizuar i armëve që shet ose i dorëzon armë dhe municion personave që sipas dispozitave të këtij ligji nuk mund t'i posedojnë ato (neni 27 paragrafi 1),
- 5) nuk njofton në afatin e caktuar për shitjen e armës dhe të municionit (neni 27 paragrafi 2),

- 6) e jep armën që është objekt i regjistrimit të detyrueshëm për përdorim nga një person i mitur ose jashtë poligoneve sportive apo vendeve të caktuara për stërvitje në qitje dhe jo nën mbikëqyrjen e një profesionisti (neni 32 paragrafi 6),
 - 7) nuk raporton ndryshimin e emrit ose të adresës së selisë (neni 37),
 - 8) transporton pa autorizim më shumë se 500 copë municione (neni 57),
 - 9) nis tregtimin e armëve të prodhuara, të cilat nuk janë markuar me vulë ose në përputhje me rregullat për testimin, markimin me vulë dhe markimin e armëve të vogla të zjarrit (neni 71 paragrafi 1),
 - 10) tregton armë dhe municione pa autorizim (neni 71 paragrafi 1),
 - 11) nis tregtimin e armëve dhe municioneve përpara se komisioni të konfirmojë përmbushjen e kushteve për fillimin e punës (neni 72 paragrafi 2),
 - 12) i beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armëve dhe municionit të tregtuar personave që nuk posedojnë autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 72 paragrafi 2),
 - 13) riparon dhe konverton armë pa autorizim (neni 73 paragrafi 1),
 - 14) nis veprimtarinë e riparimit dhe të konvertimit të armëve përpara se komisioni të konfirmojë se janë përmbushur kushtet për fillimin e punës (neni 73 paragrafi 2),
 - 15) i beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armës, gjatë riparimit ose konvertimit, personave që nuk posedojnë autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 73 paragrafi 2),
 - 16) armën e konvertuar nuk e dorëzon për testim dhe markim më vulë (neni 74 paragrafi 1),
 - 17) pranon për riparim ose konvertim armë të paregjistruara (neni 74 paragrafi 2),
 - 18) nuk njofton në afatin e caktuar lidhur me konvertimin e armës (neni 74 paragrafi 2),
 - 19) nxjerr armën e pranuar për riparim ose konvertim nga ambientet e caktuara të punës përpara se t'ia dorëzojë pronarit (neni 75 paragrafi 1),
 - 20) transporton armë pa autorizim ose në kundërshtim me udhëzimet e përcaktuara në autorizim (neni 76 dhe neni 77 paragrafi 2),
 - 21) ngre poligon civil qitjeje pa autorizim (neni 79 paragrafi 1),
 - 22) ngre poligon civil qitjeje përpara se të konfirmohet plotësimi i kushteve për fillimin e punës (neni 79 paragrafi 2),
 - 23) ia beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armëve dhe municioneve në poligonin civil personave që nuk posedojnë leje për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 79 paragrafi 2),
 - 24) lejon kryerjen e qitjeve në poligon civil nga persona fizikë të paautorizuar për të poseduar armë (neni 80 paragrafi 1),
 - 25) lejon kryerjen e qitjeve nga të miturit, në kundërshtim me dispozitën e nenit 80 paragrafi 2 të këtij ligji
 - 26) importuesi që nuk vepron në përputhje me dispozitat e nenit 84 të këtij ligji,
 - 27) nuk mban të dhënat sipas nenit 90 paragrafi 3 të këtij ligji,
 - 28) vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 90 paragrafi 5 të këtij ligji,
- Për kundërvajtjet sipas paragrafit 1 pika 1, 2, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 14, 16, 17, 20, 21, 22, 23, 24, 25 dhe 26 të këtij neni jepet dhe masa mbrojtëse e sekuestrimit të armës dhe municionit.
- Për kundërvajtje sipas paragrafit 1 pika 3 të këtij neni jepet dhe masa mbrojtëse e sekuestrimit të municionit.
- Për kundërvajtje sipas paragrafit 1 të këtij neni, krahas penaltetit në të holla, mund të jepet dhe masa mbrojtëse e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së tregtisë, riparimit dhe konvertimit të armëve ose menaxhimit të poligonit civil të qitjes.

Neni 95

Personat juridikë dënohen për kundërvajtje me gjobë në të holla nga 20 000,00 deri në 200 000,00 kuna nëse:

- 1) blen dhe mban armë për blerjen e të cilave duhet të merret autorizim (neni 10),
- 2) blen municion pa autorizim nga organi kompetent (neni 23 paragrafi 1),

- 3) i shet municion personave juridikë që nuk disponojnë autorizim për blerje municioni (neni 23 paragrafi 1),
- 4) tregtari i autorizuar i armëve ia shet ose ia dorëzon armën një personi që, sipas dispozitave të këtij ligji, nuk mund ta posedojë atë (neni 27 paragrafi 2)
- 5) nuk njofton për shitjen e armës dhe të municionit brenda afatit të caktuar (neni 27 paragrafi 4),
- 6) armën që është objekt i regjistrimit të detyrueshëm ia jep për përdorim personave të mitur ose jashtë poligoneve sportive apo vendeve të caktuara për stërvitje në qitje dhe pa mbikëqyrjen e një profesionisti (neni 32 paragrafi 6),
- 7) jep armën për përdorim në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 paragrafi 1 të këtij ligji,
- 8) nuk njofton në afatin e caktuar për ndryshimin e emrit personal ose të adresës së banimit (neni 37),
- 9) prodhon armë pa autorizim (neni 66 paragrafi 1)
- 10) nis prodhimin e armëve përpara se komisioni të konfirmojë se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës (neni 69 paragrafi 1),
- 11) ia beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armës në prodhim personave që nuk posedojnë autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 70 paragrafi 1),
- 12) nuk siguron mbrojtjen e ambienteve në të cilat ruhen armët e prodhuara nga hyrja e personave të paautorizuar (neni 70 paragrafi 3),
- 13) nis tregtimin e armëve të prodhuara, të cilat nuk janë markuar me vulë ose markuar në përputhje me rregullat për testimin, markimin me vulë dhe markimin e armëve të zjarrit të dorës (neni 71 paragrafi 1),
- 14) prodhuesi i armëve nuk vepron në përputhje të dispozitat e nenit 71 paragrafi 2 të këtij ligji,
- 15) tregton armë dhe municione pa autorizim (neni 72 paragrafi 1)
- 16) nis tregtinë e armëve dhe municioneve përpara se komisioni të konfirmojë se janë përmbushur kushtet për fillimin e punës (neni 72 paragrafi 2),
- 17) ia beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armës dhe municionit të tregtuar personave që nuk posedojnë autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 72 paragrafi 2),
- 18) riparon dhe konverton armë pa leje (neni 73 paragrafi 1),
- 19) nis veprimtarinë e riparimit dhe të konvertimit të armëve përpara se komisioni të konfirmojë se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës (neni 73 paragrafi 2),
- 20) ia beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armës gjatë riparimit ose konvertimit personave që nuk posedojnë autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 73 paragrafi 2),
- 21) armën e konvertuar nuk e dorëzon për testim dhe markim me vulë (neni 74 paragrafi 1),
- 22) pranon për riparim ose konvertim armë të paregjistruara (neni 74 paragrafi 2),
- 23) nuk njofton për konvertimin e armës brenda afatit të caktuar (neni 74 paragrafi 3),
- 24) armën e pranuar për riparim ose konvertim e nxjerr jashtë ambienteve të caktuara të punës, përpara se t'ia dorëzojë pronarit të saj (neni 75 paragrafi 1),
- 25) transporton armë pa autorizim ose në kundërshtim me udhëzimet e përcaktuara në të (neni 76 dhe neni 77 paragrafi 2),
- 26) ngre poligon civil qitjeje pa leje (neni 79 paragrafi 1),
- 27) ngre poligon civil qitjeje përpara se të konfirmohet se janë përmbushur kushteve për fillimin e punës (neni 79 paragrafi 2),
- 28) ia beson përdorimin e drejtpërdrejtë të armës dhe municioneve në poligon civil personave që nuk posedojnë autorizim për përdorim të drejtpërdrejtë të armëve të zjarrit (neni 79 paragrafi 2),
- 29) lejon që të kryejnë qitje në poligon civil persona fizikë të paautorizuar për të poseduar armë (neni 80 paragrafi 1),
- 30) lejon kryerjen e qitjeve nga minorenë, në kundërshtim me dispozitat e nenit 80 paragrafi 2 të këtij ligji
- 31) importuesi nuk vepron në përputhje me dispozitat e nenit 84 të këtij ligji,
- 32) organizatat sportive të qitjes, organizatat e gjahtarëve dhe personat e tjerë juridikë që nuk të dhënat sipas nenit 90 paragrafi 1 të këtij ligji,
- 33) nuk mban evidencat sipas nenit 90 paragrafi 2, 3 dhe 4 të këtij ligji,
- 34) vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 90 paragrafi 5 të këtij ligji,

35) Personi juridik ruan armët e gjahtarëve – shtetas të huaj.

Për kundërvajtjet e përmendura në paragrafin 1 pika 1, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 16, 18, 19, 21, 22, 25, 26, 27, 30, 31 dhe 33 të këtij neni, jepet dhe masa sigurisë "sekuestrim i armës dhe municionit".

Për kundërvajtjet e përmendura në paragrafin 1 pika 2 të këtij neni, jepet dhe masa e sigurisë "sekuestrim i municionit".

Për kundërvajtjet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dënohet me gjobë në të holla në vlerën 5000,00 deri në 15 000,00 kuna edhe personi përgjegjës i personit juridik.

Për kundërvajtjet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, krahas gjobitjes në të holla, mund të jepet dhe masa e sigurisë "ndalim i ushtrimit të veprimtarisë së tregtisë, riparimit dhe konvertimit të armëve ose të menaxhimit të poligonit civil".

Neni 96

Për kundërvajtjet sipas nenit 91 dhe nenit 92 paragrafi 1, përveç kundërvajtjes sipas pikës 1, 9 dhe 10, nenit 93 paragrafi 1 pikat 2, 3, 4, 6, 8 dhe 9, nenit 94 paragrafi 1 pika 7, 12, 15, 18, 19, 27, 28 dhe nenit 95 paragrafi 1 pikat 3, 8, 11, 17, 20, 23, 24, 28, 29, 32, 34 dhe 35 të këtij ligji, armët dhe municioni do të sekuestrohen edhe kur procedimi mbyllet me vendimin që e shpall të pandehurin të pafajshëm dhe nëse është në interes të sigurisë publike ose të përgjithshme.

Gjyqtari i kundërvajtjes që drejtuar procesin gjyqësor, merr një vendim të veçantë për sekuestrimin e armëve dhe të municionit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Pas përfundimit të procesit të zhvilluar sipas dispozitave 91, 92, 93, 94 dhe 95 të këtij ligji, armët e sekuestruara dhe municioni i dorëzohen Ministrisë së Punëve të Brendshme.

XVIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 97

Shtetasit që posedojnë në mënyrë të paligjshme armë të kategorive A, B, dhe C duhet të informojnë për këtë Drejtorinë e Policisë ose rajonin më të afërt të policisë, me qëllim dorëzimin ose çaktivizimin e tyre.

Organi kompetent sekuestron armët dhe municionet sipas paragrafit 1 të këtij neni në vendin ku ato gjenden. Organi kompetent i lëshon shtetasit një vërtetim për armët dhe municionet e sekuestruara sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Nëse shtetasi dëshiron që të çaktivizojë armën sipas paragrafit 1 të këtij neni, ai duhet t'i paraqesë organit kompetent një kërkesë për çaktivizimin e armës brenda tetë ditësh nga data e dorëzimit të saj.

Shpenzimet e çaktivizimit të armës mbuloohen nga aplikanti.

Nëse shtetasit veprojnë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni dhe përpara hetimit policor në përputhje me ligjin për kundërvajtjet dhe fillimin e hetimit të veprave penale dhe procedurat hetimore urgjente paraprake, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale ose fillimit të zbatimit të kompetencave policore të parashikuara në ligjin për policinë, nuk do të nisë procedim për shkelje apo penal.

Neni 98

Nëse një shtetas posedon armë pa autorizim arme ndonëse, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ato mund të posedohen vetëm në bazë të dokumenteve të vlefshme të armëve, ai duhet të informojë për posedimin e tyre organin kompetent dhe t'i regjistrojë ato brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Nëse shtetasit veprojnë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, përpara fillimit të hetimeve të policisë në përputhje me ligjin për kundërvajtjet, përpara fillimit të hetimeve për veprë penale e të procedurave hetimore paraprake emergjente në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, ose përpara fillimit të aplikimit të kompetencave policore sipas ligjit për policinë, nuk nisët asnjë procedim për kundërvajtje dhe as procedim penal.

Neni 99

Organi kompetent mund t'i lëshojë shtetasit që raporton posedimin e armës sipas nenit 98 paragrafi 1 të këtij ligji leje arme pa konfirmim të origjinës së saj, nëse plotësohen kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 10 të këtij ligji dhe kushtet sipas nenit 85 paragrafi 1 të këtij ligji.

Nëse shtetasi nuk plotëson kushtet e paragrafit 1 të këtij neni, armët sekuestrohen dhe veprohet sipas dispozitave të neneve 50 dhe 51 të këtij ligji.

Nëse arma e raportuar është tashmë e regjistruar në emër të një personi tjetër, me vendim të veçantë ajo mund t'i jepet në ruajtje shtetasit sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëse ai plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 10 të këtij ligji. Nëse shtetasi nuk i plotëson këto kushte, arma sekuestrohet pa të drejtë kompensimi.

Organi kompetent nis procedim për kundërvajtje kundër personit në emër të të cilit është regjistruar arma sipas paragrafit 3 të këtij neni për të vendosur në lidhje me disponimin e armës.

Organi kompetent mund t'i lëshojë personit të cilit i është besuar arma për ruajtje autorizim për posedim ose për posedim dhe mbajtje të armës, nëse ai plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 10 të këtij ligji, me kusht që kundër personit në emër të të cilit është regjistruar arma të mos jetë caktuar me vendim të formës së prerë sipas paragrafit 4 të këtij neni masa e sigurisë "sekuestrim i armës dhe municionit".

Nëse në procedimin sipas nenit 4 të këtij neni nuk është caktuar masa e sigurisë "sekuestrim i armës dhe municionit", shtetasi të cilit i është besuar arma për ruajtje duhet t'ia dorëzojë atë organit kompetent, pas njoftimit me shkrim, brenda 60 ditësh nga data në të cilën vendimi mori formë të prerë sipas paragrafit 4 të këtij neni. Ai nuk gëzon të drejtën e kompensimit për armën e dorëzuar.

Neni 100

Personat fizikë që posedojnë armë të cilat, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mbahen pa autorizim duhet t'ia raportojnë ato organit kompetent brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 101

Brenda dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqitë këtij ligji, personat fizikë të cilëve u është lëshuar autorizim për posedim armësh si kujtim, duhet:

- 1) ta shesin armën ose
- 2) të bëjnë kërkesë për lëshim të autorizimit së për posedim ose të autorizimit për posedim dhe mbajtje arme

Ose

- 3) ta çaktivizojnë arën dhe ta mbajnë, ose
- 4) t'ia dorëzojnë armën Republikës së Kroacisë, kundrejt asnjë kompensimi.

Neni 102

Personat fizikë të cilëve u është lëshuar autorizim për posedimin e armëve si kujtim, për armët e kategorisë A të mara si plaçkë lufte, janë të detyruar që brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, t'ia dorëzojnë organit kompetent konfirmimin nga shoqëria tregtare ose tregtari se disponon leje nga Ministria e Punëve të Brendshme për kryerjen e veprimtarisë së riparimit dhe të konvertimit të armëve që vërteton se arma është çaktivizuar në mënyrë të përhershme.

Neni 103

Personat fizikë të cilëve u është lëshuar autorizim për posedim të armëve nga bashkëpërdorues ose për posedim dhe mbajtje të armëve nga bashkëpërdorues, janë të detyruar që brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, t'i dorëzojnë organit kompetent dokumentet e lartpërmendura.

Neni 104

Personi fizik dënohet për kundërvajtje me gjobë në të holla nga 5000,00 deri në 15 000,00 kuna dënohet nëse:

- 1) nuk raporton armën e kategorisë C brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj (neni 100)
 - 2) nuk vepron në përputhje me dispozitën e nenit 101 të këtij ligji brenda afatit të parashikuar në të
 - 3) nuk vepron në përputhje me dispozitën e nenit 101 të këtij ligji, brenda afatit të përcaktuar në të.
- nuk vepron në përputhje me dispozitën e nenit 102 të këtij ligji, brenda afatit të përcaktuar në të.

Për kundërvajtjet sipas paragrafit 1 të këtij neni jepet dhe masa e sigurisë "sekuestrim i armës dhe municionit". Pas përfundimit të procedurës së vlefshme ligjore të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, armët dhe municioni i sekuestruar i dorëzohet Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Neni 105

Me gjobë në të holla nga 500,00 deri në 2000,00 kuna dënohet për kundërvajtje personi fizik që nuk i dorëzon organit kompetent autorizimin për posedim të armëve nga bashkëpërdorues ose për posedim dhe mbajtje të armëve nga bashkëpërdorues, brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj (neni 103)

Neni 106

Procedimet administrative dhe për kundërvajtje, të nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundohen në përputhje me ligjin "Për armët" (Fletoret zyrtare nr. 69/92, 26/93, 43/93, 29/94, 108/95, 20/97, 27/99, 12/01 dhe 19/02)

Neni 107

Ministri i punëve të brendshme përcakton:

- 1) përmbajtjen, formën dhe tarifën e dokumenteve të armëve, si dhe përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit dhe afatet e ruajtjes së të dhënave në regjistrin e mbajtur nga organi kompetent, Ministria e Punëve të Brendshme dhe personat fizikë e juridikë.
- 2) përmbajtjen, formën dhe tarifën e aplikimit për lëshimin e autorizimit për posedim dhe mbajtje të armëve për qëllime sportive dhe gjuetie gjatë kohës së qëndrimit në Republikën e Kroacisë dhe të autorizimit për transferim të armëve nëpër territorin e Republikës së Kroacisë.
- 3) përmbajtjen, formën dhe tarifën e kërkesës për lëshim të autorizimit për posedim arme dhe të lejes për regjistrimin e armës.
- 4) procedurën dhe mënyrën e çaktivizimit të armëve të zjarrit
- 5) programin dhe mënyrën e aftësimit të qytetarëve për përdorimin e duhur të armëve të zjarrit.
- 6) mënyrën e asgjësimit të armëve dhe municioneve të sekuestruara gjatë procedimeve administrative, të kundërvajtjeve dhe atyre penale.
- 7) mënyrën e veprimit të punonjësve të policisë gjatë kërimit dhe mbledhjes së informacionit nga qytetarët gjatë procedurave që zhvillohen në përputhje me këtë ligj.
- 8) llojet dhe kalibrat e lejuar të armëve për qëllime vetëmbrojtjeje,
- 9) veprimtaritë e komisionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili vendos për armët e sekuestruara përmes procedimit penal, administrativ dhe për armët e dorëzuara dhe mënyrën e procedimit me këto armë.

10) procedurën e regjistrimit të markimit mekanik të armës dhe mënyrën, procedurën dhe afatet brenda të cilave personat fizikë e juridikë duhet t'i dorëzojnë armët Ministrisë së Punëve të Brendshme me qëllim marrjen e gjurmës mekanike të armës,

11) përbërjen dhe objektin e punës së komisionit sipas nenit 69 të këtij ligji.

Ministri i punëve të brendshme, me miratimin e ministrit përgjegjës për sportet, përcakton llojet dhe kalibrat e lejuar të armëve sportive.

Ministri i punëve të brendshme, me miratimin e ministrit të ngarkuar me çështjet e ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit, përcakton kushtet e veçanta që duhet të plotësojnë personat juridikë të cilëve u është lëshuar autorizim për blerje arme, ambientet për prodhimin, tregtimin e armëve dhe të municioneve, riparimin dhe konvertimin e armëve, menaxhimin e poligoneve civile të qitjes, si dhe për mbrojtjen nga zjarri, vjedhja dhe keqpërdorimet e aksidenteve të tjera.

Ministri përgjegjës për çështjet e shëndetit, me miratimin e ministrit të punëve të brendshme, përcakton mënyrën dhe procedurën sipas të cilës mjeku sipas nenit 11 paragrafi 6 i këtij ligji do të njoftojë organin kompetent mbi ndryshimin e gjendjes shëndetësore të zotëruesit të armës, e cila ndikon në aftësinë për të poseduar dhe mbajtur armë.

Ministri i punëve të brendshme, me miratimin e organeve kompetente për standardizimin dhe metrologjinë, përcakton:

1) procedurën e testimit dhe të markimit me vulë të armëve të zjarrit, si dhe pjesët kryesore të armëve të zjarrit që do t'i nënshtrohen testimit të detyrueshëm dhe markimit me vulë pas konvertimit.

2) markimet me vulë dhe markimet e tjera që do t'u vendosen armëve, formën dhe përmbajtjen e autorizimeve dhe etiketave.

Ministri i ngarkuar me çështjet e shëndetit përcakton:

1) kushtet që duhet të plotësojnë institucionet shëndetësore, shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime mjekësore në punë dhe zyrat private të specializuara në ofrimin e shërbimeve mjekësore në punë për të kryer kontrole shëndetësore për konfirmimin e aftësisë për të poseduar dhe mbajtur armë dhe mbikëqyrjen e punës së tyre.

2) mënyrën dhe procedurën e kryerjes së kontrolleve shëndetësore, regjistrimin e sëmundjeve dhe gjendjeve shëndetësore të cilat e bëjnë personin të paaftë për të poseduar dhe mbajtur armën.

3) mënyrën e mbajtjes së regjistrit dhe të dokumentacionit shëndetësor dhe përmbajtjen e vërtetimit pas kryerjes së kontrollit shëndetësor.

4) kompetencat, përbërjen dhe mënyrën e punës së komisionit shëndetësor të shkallës së dytë dhe procedurën për rastet e ankimimit.

5) tarifën për konfirmimin e aftësisë shëndetësore,

6) institucionet shëndetësore, shoqëritë tregtare të cilat kryejnë kontrole për përcaktimin e aftësisë për punë dhe specialistët mjekësorë privatë që kanë të drejtë të kryejnë kontrole shëndetësore.

Rregullat për zbatimin e këtij ligji miratohen nga ministrat dhe kreu i organit kompetent për çështjet e standardizimit dhe metrologjisë brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të cilët kanë kompetencat për miratimin e tyre, në përputhje me këtë ligj.

Neni 108

Institucionet shëndetësore, shoqëritë tregtare të cilat kryejnë kontrole shëndetësore për përcaktimin e aftësisë për punë dhe specialistët mjekësorë privatë që kanë të drejtë të kryejnë kontrole shëndetësore për posedim ose për posedim dhe mbajtje të armëve, duhet të koordinojnë organizimin dhe veprimtarinë e tyre brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Institucionet shëndetësore, shoqëritë tregtare të cilat kryejnë kontrole mjekësore për përcaktimin e aftësisë për punë dhe specialistët mjekësorë privatë që kanë të drejtë të kryejnë kontrole shëndetësore për posedim ose për posedim dhe mbajtje të armëve, të cilët nuk kanë koordinuar punën e tyre dhe organizimin në afatin sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk i ofrojnë më shërbimet e kryerjes së vizitave shëndetësore për posedim dhe mbajtje të armëve pas skadimit të këtij afati.

Neni 109

Deri në miratimin e rregulloreve për zbatimin e ligjit "Për armët", do të zbatohet rregullorja për formularët dhe regjistrat e armëve dhe municioneve (Fletorja zyrtare nr. 118/99, 45/01, 17/02, 148/02, 29/03 dhe 173/03), rregullorja për kushtet e veçanta që duhet të përmbushin ambientet e punës për prodhimin e armëve, tregtinë e armëve dhe municioneve, riparimin dhe konvertimin e armëve, si dhe për drejtimin e poligoneve civile të qitjes, mbrojtjen nga zjarri, vjedhjet dhe aksidente e keqpërdorime të tjera (Fletorja zyrtare nr.8/93) dhe rregullorja për kontrollet shëndetësore për verifikimin e aftësisë shëndetësore për të poseduar dhe mbajtur armë (Fletorja zyrtare nr. 79/92).

Neni 110

Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dispozitat e nenit 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 45, 46 dhe 47 të ligjit "Për kontrollin e kufirit shtetëror" (Fletorja zyrtare nr. 9/92, 26/93 dhe 92/94)

Neni 111

Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji "Për armët" (Fletorja zyrtare, nr. 69/92, 26/93, 43/93, 29/94, 108/95, 20/97, 27/99, 12/01 dhe 19/02).

Neni 112

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2007, përveç dispozitave të nenit 23, 62, 63, 64 dhe 65 të tij, të cilat hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit me të drejta të plota të Kroacisë në Bashkimin Evropian dhe dispozitave të neneve 82, 83, 84, 85 dhe 86 të këtij ligji, të cilat hyjnë në fuqi më 1 janar 2008.

Kategoria: 213-02/06-01/01
Zagreb, më 1 qershor 2007

PARLAMENTI KROAT
Kryetari
i Parlamentit Kroat
Vladimir Šeks, d.v.